



# **RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR** **AUDITIMIN TEMETIK**

## **“BASHKIA DIBËR”**

**Auditim Financiar, mbi pasqyrat  
financiare**

**Viti 2020**

Tiranë, 2021

**PËRMBAJTJA:**

| NR            | EMËRTIMI I KAPITUJVE                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | FAQE           |
|---------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|
| <b>I</b>      | <b>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | <b>4 - 11</b>  |
| <b>I.2</b>    | <b>Konkluzioni dhe Opinioni Auditimit</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | <b>11 - 12</b> |
| <b>II</b>     | <b>HYRJA</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | <b>12 - 18</b> |
|               | a. Titulli.<br>b. Marrësi.<br>c. Objektivat dhe qëllimi.<br>d. Identifikimi i çështjes.<br>e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.<br>f. Përgjegjësitë e Audituesve.<br>g. Kriteret e vlerësimit.<br>h. Standardet e auditimit.<br>i. Metodat e auditimi.<br>j. Dokumenti i auditimit.                                                                                                                                                                                                                                                           |                |
| <b>III.</b>   | <b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | <b>17 - 37</b> |
| <b>III.1.</b> | <b>Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | <b>17 - 18</b> |
| <b>III.2.</b> | <b>Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | <b>18 -34</b>  |
|               | <i>A-Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe UMFE nr.08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme".</i> |                |
| <b>IV.</b>    | <b>KONKLUZION I PËRGJITHËHM DHE OPINIONI I AUDITIMIT</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | <b>34 - 37</b> |
| <b>V.</b>     | <b>GJETJE DHE REKOMANDIMI</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | <b>37 - 42</b> |
| <b>VI.</b>    | <b>ANEKSET</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | <b>42 - 58</b> |

## SHKURTIME

|                |                                                                  |
|----------------|------------------------------------------------------------------|
| <b>KLSH</b>    | Kontrolli i Lartë i Shtetit.                                     |
| <b>MFK</b>     | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.                               |
| <b>NA</b>      | Nëpunës Autorizues.                                              |
| <b>NZ</b>      | Nëpunës Zbatues.                                                 |
| <b>GSM</b>     | Grupi i Menaxhimit Strategjik.                                   |
| <b>FZHR</b>    | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve                                   |
| <b>AQT</b>     | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.                             |
| <b>UMFE</b>    | Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë                  |
| <b>VKM</b>     | Vendim i Këshillit të Ministrave.                                |
| <b>VKB</b>     | Vendim i Këshillit Bashkiak.                                     |
| <b>ISSAI</b>   | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. |
| <b>INOTSAI</b> | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.  |
| <b>ISA</b>     | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit                            |
| <b>IFAC</b>    | Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve                        |
| <b>IPSAS</b>   | Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik   |
| <b>IT</b>      | Teknologjia e Informacionit.                                     |
| <b>NJA</b>     | Njësi Administrative.                                            |

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, monitorimi i tyre nga Auditimi i Brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet, për një qeverisje të mirë dhe transparente, në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Dibër.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga SIFQ<sup>1</sup>, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, si më poshtë:

Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”; Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”; Llogaritë 230 dhe 231 “Investime...”; Llogaritë 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, “Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive”; Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”; Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”; Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione”; Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”; Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”; Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune”; Llogaria 215 “Mjete transporti”; Llogaria 218 “Inventar ekonomik”; Llogaritë e Klasës 25/26 “Aktivet Afatgjata Financiare”; Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”; Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”; Llogaria 4342 “Operacione me shtetin”; Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”; Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”; Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”; Llogaria 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”; Llogaria “435 “Sigurime Shoqërore”; Llogaria “436 “Sigurimet shëndetësore”; llogaritja dhe paraqitja e amortizimit, etj. 600 “Paga”, 602 “Shpenzime operative” dhe 230-231 “Investime”.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (balance) të viti 2020, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një “Opinion i kualifikuar”, pasi disa nga llogaritë nuk paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, performancës financiare dhe fluksin e parasë në përputhje me kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

### I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Rëndësia | Referenc<br>a<br>në<br>Raport | Rekomandimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|-------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1.         | Në rubrikën, aktive afat shkurtra, nën/rubrika, llogari të arkëtueshme, gjendja e llog.(468) “Debitorë të ndryshëm” në pasqyrat e pozicionit financiar në vitin 2020 paraqitet me vlerë 88,410,386 lekë e cila përfaqëson detyrime të shtuara nga subjekte të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore e detyrime të rezultuara në aktkontrolle të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2020. Nga analiza e kësaj | E lartë  | 18-34                         | Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike, nëpërmjet Sektorit të Financës në bashkëpunim me Sektorin e taksave e tarifave vendore, të analizojnë dhe të marrin masa për sistemimin e vlerës së detyrimeve debitorë për taksat/tarifat e bizneseve/familjare, si dhe detyrime të tjera bazuar në listën e debitorëve gjendje në fund të vitit 2020 |

<sup>1</sup> Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Rëndësia | Referenc<br>a<br>në<br>Raport | Rekomandimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|-------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|            | <p>llogarie rezulton se; për periudhën raportuese 2020 kjo vlerë përbëhet me analizë të hollësishme nga;</p> <p>-Debitorë për taksat e tarifave vendore në vlerën 8,619,354 lekë.</p> <p>-Debitorë të rekomanduar nga KLSH në vlerën 73,085,749 lekë.</p> <p>-Debitorë të kopshteve e çerdheve në vlerën 2,956,340 lekë.</p> <p>-Debitorë për letrat me vlerë në shumën 3,749,281 lekë.</p> <p>Në këtë llogari janë nuk të pasqyruar të gjitha detyrimet debitorë të subjekteve private të lindura nga mos pagimi i nivelit të taksave e tarifave vendore, sepse nga evidentimi që bën Sektori Taksave e Tarifave Vendore, debitorët nga subjektet taksapagues privat dhe familjar janë në vlerën prej 40,132,137 lekë, ndërsa në pasqyrat financiare paraqiten me vlerën 8,619,354 lekë, me diferencë më pak prej 31,52,783 lekë. Në këtë mënyrë pasqyrat financiare për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e detyrimeve debitorë, veprim në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, aneksi 1, pika 3.3</p> |          |                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| 2.         | <p>Në rubrika, aktivet afat gjata, nën/rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja e llog.(210) “Toka, Troje, Terrene” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet me vlerë 28,394,404 lekë e pa ndryshuar nga periudhat paraardhëse. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera ndër vite, kryesisht për shpronësim trualli shkolla e mesme, konvikti dhe shpronësim rruge tek gjimnazi i ri. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se, nuk është e pasqyruar:</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | E lartë  | 18-34                         | <p>Nga Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike nëpërmjet Sektorit të Financës të marr masa për të pasqyruara në llog.(210) “Toka, Troje, Terrene” edhe vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llog.(212) “Ndërtime e konstruksione”, vlera e të cilëve me VKM ka kaluar në pronësi të Bashkisë Dibër, njëkohësisht të kryhet inventarizimi i trojeve me komision inventarizimi</p> |

| Gjetja<br>Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Rëndësia | Referenc<br>a<br>në<br>Raport | Rekomandimi |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|-------------------------------|-------------|
|               | <p><b>a)</b> Vlera e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të konvikteve, godina e Bashkisë, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj., sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llog.(212) “Ndërtime e konstruksione”, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(II), pika 11, aneksi 1, pika 2 klasa 2.</p> <p><b>b)</b> Vlerat e trojeve të cilat kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Dibër, përkatësisht me VKM nr.1533, datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Peshkopi, qarku Dibër”; VKM nr.1179, datë 20.08.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në Komunën Melan, të qarkut të Dibrës”; VKM nr.1001 datë 10.12.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Arras, të qarkut të Dibrës”, veprim në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 30,</p> <p><b>c)</b> Nuk është kryer inventarizimi fizik dhe vlerësimi i trojeve, me komision të ngritur nga titullari i njësisë vendore, veprim në mospërputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. IV, pikat 74; 96, UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave</p> |          |                               |             |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Rëndësia | Referenc<br>a<br>në<br>Raport | Rekomandimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|-------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|            | <i>financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(II), pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |          |                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| 3.         | <p>Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja e llog.(211) <b>“Pyje, kullota, plantacione”</b> në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet me vlerë 2,468,000 lekë me ndryshime gjatë vitit për shtesën 1,200,000 lekë e cila përfaqëson vlerën e investimit të kryer me objekt “ndërtim lere”, vlerë e cila duhet të administrohet dhe kontabilizohet në llog.(213) <b>“Rrugë, rrjete, vepra ujore”</b>. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se nuk janë pasqyruar:</p> <p><b>a)</b> Vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Dibër, të transferuara me VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish/Komunat/Bashkive”, pika 8, shtojca nr.6 e cila përmban listën e inventarit të pyjeve e kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Dibër, nga nr.1(një) deri nr.2327 (dymijë e treqind e njëzet e shtatë). Sipas këtij vendimi Bashkia Dibër ka në pronësi gjithsej 36,662 ha (nga e cila 25,351 ha pyje; 5,412 ha kullotë; 534 ha sipërfaqe bimësi pyjore; 3,417 ha sipërfaqe inproduktive; 1,889 ha sipërfaqe djerr dhe 57 ha sipërfaqe ujore). Veprim në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(II), pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2.</p> <p><b>b)</b> Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i pyjeve e kullotave me komision të ngritur nga Titullari</p> | E lartë  | 18-34                         | Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Sektorin e Pyjeve e Kullotave, të marrin masa për inventarizimin e pronave të cilat janë në pronësi të Bashkisë Dibër, si dhe të bëhet pasqyrimi i saktë në dokumentet kontabël vlerës së llog.(211) <b>“Pyje, kullota, plantacione”</b> . Njëkohësisht Drejtoria Ekonomike të bëjë sistemimin nga kjo llogari të vlerës së investimit të kryer me objekt “ndërtim lere” me vlerë 1,200,000 lekë e cila duhet të administrohet në llog.(213) <b>“Rrugë, rrjete vepra ujore”</b> |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Rëndësia | Referenc<br>a<br>në<br>Raport | Rekomandimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|-------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|            | Institucionit. Llog.(211) “Pyje, kullota, plantacione” nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësive vendore, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap IV, pikat 74, 96 dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. II, pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |          |                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| 4.         | Në rubrikën, aktivet afat gjata. nënrubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja në llog.(212) “Ndërtim e konstruksione” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet me vlerë 901,645,234 lekë e cila përfaqëson vlerën e investimeve të kryera gjatë vitit për ndërtim e rikonstruksione në 97,436 lekë dhe paksime në vlerën 47,455,012 lekë e amortizimit vjetor. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;<br><b>a)</b> Nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë, që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksionit të objekteve, vlera mbikëqyrjes e kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë kosto të mëpasshme duhet të shtohen koston fillestare të AAGJM <sup>së</sup> . Investimet në total shtesë deri në 31.12.2020 janë në vlerën 422,160,312 lekë për 22 objekte të evidentuar (Aneksi nr.5), bashkëlidhur. Veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë | E lartë  | 18-34                         | Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike, nëpërmjet Sektorit të Financës të analizojë dhe të marrë masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material në llog.(212) “Ndërtim e konstruksione”, duke shtuar në vlerën fillestare edhe vlerën e shpenzimit të investimit të ri për secilin objekt (rikonstruksion etj.). Njëkohësisht nëpunësi autorizues e zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik të Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM). |



| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Rëndësia | Referenc<br>a<br>në<br>Raport | Rekomandimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|-------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|            | <p>09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, germa (b).</p> <p><b>b)</b> Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, veprim në mospërputhje me ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, pika 1; 2, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. IV, pika 74 dhe 96 dhe UMF nr. 08, datë 09.03.2018”</p> <p>Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36, paragraf (4)</p>                                                                                                                                                                                                                        |          |                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| 5.         | <p>Në rubrikën, aktivet afat gjata, nënrubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja në llog.(215) “Mjete transporti” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet me vlerë 34,745,237 lekë e cila përfaqëson vlerën e mjeteve ndër vite, shtesat gjatë periudhës e pakësimet nga amortizimi për periudhën raportuese ushtrimore. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se:</p> <p><b>a)</b> Në llog.(215) “Mjete transporti” të pasqyrave të pozicionit financiar është pasqyruar gabim vlera 10,061,498 lekë për 8 (tetë) mjete transporti gjendje të dëmtuara, kontabilizimi i gabuar në këtë llogari, ndërsa në fakt duhej të ishin regjistruar e kontabilizuar në llog.(24) “Aktive afatgjata të dëmtuara” për 8 (tetë) mjete transporti të cilat nuk janë në gjendje pune, por të dëmtuar, sipas (Aneksit nr.7), bashkangjitur, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në</p> | E lartë  | 18-34                         | <p>Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike, nëpërmjet Sektorit të Financës të analizojë dhe të marrë masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël për sistemimin e veprimeve për AAGJM dhe evidentimin e 8 mjete transporti të dëmtuar, me veprime kontabël, kreditim llog.(215) “Mjete Transporti” dhe debitim llog.(24) “Aktive afat gjata të dëmtuara” për vlerën përkatëse 10,061,498 lekë</p> |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | Rëndësia | Referenca në Raport | Rekomandimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|---------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|            | <i>njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i> ”, Kap.(II), pika 11, aneksi 1, pika 2/1, germa (e), pika 36                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |          |                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| 6          | Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, investime, gjendja në llog.(230) “Për Aktive afatgjata jo materiale” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet me vlerë 18,131,232 lekë e cila përfaqëson vlerën e studime e projekte për investimet në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor, ndërsa do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre, kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë në llogaritë të Klasës (2) “Aktive afat gjata materiale”. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;<br>-Sektori financës ka të analizuar e dokumentuar në mënyrë analitike e justifikuese vlerën e pasqyruar të pozicionit financiar vetëm për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 për 4 objekte me vlerë 6,907,636 lekë, ndërsa për periudhat paraardhëse nuk disponohet asnjë analizë dhe dokument justifikues, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(II), pikat 6; 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi “Trajtimi kontabël dhe funksionimi”, grupi (20) “Aktive afatgjata jo materiale”; pika 18 | E lartë  | 18-34               | Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike, nëpërmjet Sektorit të Financës të analizojë dhe të marrë masa për evidentimin dhe dokumentimin në mënyrë analitike për vlerën e studimeve e projekteve për investimet në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit pasqyruar në llog.(230) “Për Aktive afatgjata jo materiale” në vlerë 18,131,232 lekë |
| 7          | Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, investime, gjendja në llog.(231) “Për aktive afatgjata materiale” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, paraqitet me vlerë 545,659,534 lekë, e cila përfaqëson vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre, kur ato të kthehen aktive dhe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | E lartë  | 18-34               | Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike, nëpërmjet Sektorit të Financës të analizojë dhe të marrë masa për evidentimin dhe dokumentimin në mënyrë analitike për vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe të pasqyruara në llog.(231) “Për aktive afatgjata materiale” në vlerë 545,659,534 lekë            |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Rëndësia | Referenc<br>a<br>në<br>Raport | Rekomandimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|-------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|            | <p>kalojnë te llogaritë Klasa (2) “Aktive afat gjata materiale”. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;</p> <p>-Sektori financës ka të analizuar e dokumentuar në mënyrë analitike e justifikuese vlerën e pasqyruar të pozicionit financiar vetëm për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 për 5 objekte me vlerë 330,426,810 lekë, ndërsa për periudhat paraardhëse nuk disponohet asnjë analizë dhe dokument justifikues, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(II), pikat 6; 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi “Trajtimi kontabël dhe funksionimi grupi (20) "Aktive afatgjata jomateriale" dhe pika 18</p>                                                                                                       |          |                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| 8          | <p>Në rubrikën, pasivet afat shkurtra, nën/rubrika, llogari të pagueshme, gjendja në llog.(466) “Kreditorë për mjete në ruajtje” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet me vlerë 49,734,802 lekë e cila përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për 5% garanci në punimet e objekte të ndryshme të përfshirë ndër vite. Gjatë periudhës raportuese ushtrimore viti 2020, Sektori financës ka dokumentuar ngurtësime në vlerë 19,872,954 lekë për 12 OE, ndërsa ka likuiduar vlerën 4,792,686 lekë për 4 OE. Me degën e thesarit Dibër në datë 09.02.2021 janë mbajtur Aktrakordimin përkatësisht:</p> <p>a) për 5% e ngurtësimeve progresive në vlerën 19,872,954 lekë deri më 31.12.2020.</p> <p>b) për 5% e likuidimeve progresive në vlerën 4,792,686 lekë deri më 31.12.2020.</p> <p>Ndërmjet vlerës së ngurtësimeve prej 19,872,954 lekë dhe vlerës së</p> | E lartë  | 18-34                         | <p>Titullari Bashkisë Dibër, Drejtoria Ekonomike nëpërmjet Sektorit të Financës të analizojë dhe të marrin masa për sistemimin e llog.(466) “Kreditorë për mjete në ruajtje” për evidentimin e dokumentimin në mënyrë analitike të diferencës prej 15,080,268 lekë e pa analizuar në mënyrë analitike. Të analizojnë origjinë krijimin e saj dhe shkaqet e mos likuidimit të vlerës 13,013,172 lekë e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve për ato objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim, duke analizuar më parë gjendjen nëse është përmbyllur garancia e defekteve të punimeve, apo nëse janë bërë korrigjime të punimeve për ato kontrata që nuk është likuiduar garancia</p> |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Rëndësia | Referenc<br>a<br>në<br>Raport | Rekomandimi                                               |
|------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|-------------------------------|-----------------------------------------------------------|
|            | <p>likuidimeve prej 4,792,686 lekë rezulton diferencë për 15,080,268 lekë e cila përfaqëson gjendje në datën 31.12.2020 e llog.(466) “Kreditorë për mjete në ruajtje” për detyrime të krijuara për gjatë vitit ushtrimor 2020. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se:</p> <p><b>a)</b> Në pasqyrat e pozicionit financiar llog.(466) “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në vlerë 49,734,802 lekë e cila rakordon me gjendjen e pasqyruar, ndërsa nuk është e analizuar në mënyrë analitike për çdo objekt ndërtimi dhe operator ekonomik, si pasojë e mos pasqyrimit në Aktrakordimin dhe në evidencat analitike për të gjithë operatorët ekonomik që Bashkia ka detyrim në lidhje me vlerën e garancisë për punimet e përfunduara, apo ato në proces.</p> <p><b>b)</b> Për 33 objekte të përfunduara e të marra në dorëzim nga Bashkia që pasqyrohet në vlerën 13,013,172 lekë, sipas aneksit përkatës nuk është bërë zhbllokimi vlerës, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit, megjithëse është përmbushur afati garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga drejtoria e urbanistikës dhe financës, nuk janë marr masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar OE për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Veprime në mospërputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(III), pikat 30; 50.</p> |          |                               |                                                           |
| 9          | Njësia publike Bashkia Dibër, për vitin ushtrimor 2020 nuk ka hartuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | E lartë  | 18-34                         | Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike, nëpërmjet Sektorit të |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Rëndësia | Referenc<br>a<br>në<br>Raport | Rekomandimi                                                                                                                                                                                     |
|------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|-------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|            | <p>pasqyrat e konsoliduar në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitet publike të varësisë, për të dhënë një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për (aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet e fluksin e mjeteve monetare). Pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës viti 2020 katër njësitet ekonomike në vartësi të bashkisë Dibër i kanë dorëzuar në degën e thesarit Dibër, ndërsa nuk janë dorëzuar në Drejtorinë Ekonomike të Bashkisë Dibër. Në vartësi të njësisë publike Bashkia Dibër janë 4 (katër) Njësi publike vartësie konkretisht:</p> <p>-Njësia Ekonomike, Qendra Balneare Peshkopi,</p> <p>-Njësia Ekonomike, Qendra Kulturore Dibër,</p> <p>-Njësia Ekonomike, Shumesportesh Dibër,</p> <p>-Njësia Ekonomike, Klubi i Futbollit Dibër.</p> <p>Veprim në mospërputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; neni 9, pika 4, germa “d”, neni 12 pika 2. germa “b”; UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pikat 98; 99; 100; 101, germa “b”; pika 118</p> |          |                               | Financës të analizojnë, të marrin masa për hartimin e pasqyrave të konsoliduar në nivel të vetëqeverisjes vendore së bashku me 4 (katër) Njësitë publike ekonomike në vartësi të Bashkisë Dibër |

## I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

### **Opinioni mbi pasqyrat financiare.**

Grupi i auditimit të KLSH<sup>së</sup> ka audituar pasqyrat financiare të njësisë publike Bashkia Dibër për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, paraqitur edhe vitin pasardhës, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve

kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

**Opinion i “kualifikuar”:**

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të kualifikuar për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Dibër duke arritur në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2020”.

**Baza për opinionin e kualifikuar:**

Nga testimi llogarive konstatohet se, në dhënien e opinionit ne kemi marrë në konsideratë faktin se, disa llogari megjithëse nuk janë krijuar në periudhën ushtrimore raportuese viti 2020, kërkohet të marren masa për të sistemuar vlerat e llogarive konkretisht; llog.(468); (210); (211); (212); (215); (230-231); (466), të cilat nuk e pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së njësisë publike vendore Bashkia Dibër, duke bërë që në këto llogari në fund të vitit ushtrimor raportues të paraqitet vlera e saktë gjendje.

**Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Dibër:**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Dibër, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit regullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Dibër janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH<sup>-së</sup>:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH<sup>-së</sup>, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 678, datë 14.06.2021 dhe autorizimit nr. 678/1, datë 14.06.2021 “Mbi auditimin e pasqyrave financiare viti 2020”, të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 14.06.2021–02.07.2021, në subjektin Bashkia Dibër për periudhën e veprimtarisë nga 01.07.2019 – 31.12.2020 u krye auditimi “Auditim Financiar dhe Përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K.GJ.,** *Përgjegjës Grupi.*
2. **P.GJ.,** *Auditues.*
3. **V.R.,** *Auditues.*
- 4.

**a- Titulli:** Auditim financiar në Bashkinë Dibër.

**b- Marrësi:** Raporti i Auditimit Tematik i drejtohet subjekti të audituar Bashkia Dibër.

**c- Objektivat dhe qëllimi:** Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

**d- Identifikimi i çështjes:** Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raport i Auditimit Tematik, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë publike vendore dhe përgjegjësitë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Dibër, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Dibër.

**e- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:** Administratori i Përgjithshëm në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) D.I. me detyrë ish/Kryetar i Bashkisë Dibër dhe Drejtori i Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ) L.C., janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu në cilësinë NA dhe NZ, ata janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të

Bashkisë Dibër, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisje vendore” konkretisht neni 34, pika (6)<sup>2</sup>, neni 65, pika (1)<sup>3</sup>, neni 91, pika (1.3)<sup>4</sup>.

**f- Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:** Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Dibër dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e sigurisë së arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës mbledhur të auditimit. **Parimet e auditimit financiar:** Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- *Etika dhe pavarësia;*
- *Kontrolli i cilësisë*
- *Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre*
- *Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.*

**-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:**

- *Përkatësia:* Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
- *Plotësia:* Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Saktësia:* Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme
- *Periudha:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël
- *Klasifikimi:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura
- *Ligjshmëria dhe rregullsia:* Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

**-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

- *Ekzistenca:* asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë
- *Të drejtat dhe detyrimet:* Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit
- *Plotësia:* Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Vlerësimi dhe alokimi:* Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

**-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

- *Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:* Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

---

<sup>2</sup> “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”

<sup>3</sup> “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori”.

<sup>4</sup> “Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;  
b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;  
c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;  
ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit”.



- **Plotësia:** Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
- **Klasifikimi dhe kuptueshmëria:** Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.
- **Saktësia dhe vlerësimi:** Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

**g- Kriteret e vlerësimit:** Auditimi u bazua në ligji nr.154/14, datë 27.11.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH<sup>-së</sup> nr.196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

▪ **Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit Pasqyrave Financiare:**

Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”, aktualisht i shfuqizuar; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësisve që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr.510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr.3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

**h- Standardet e auditimit:** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH<sup>-së</sup>; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI<sup>t</sup>, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

**i- Metodatat e auditimit:** Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH<sup>-së</sup> është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhje e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

**Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit<sup>5</sup>.**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te

<sup>5</sup> **ISSAI 1320 (ISA 320)** trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:*

- **Kontrolli aritmetik.** Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- **Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.** Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- **Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.** Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- **Kontrolli i vlerësimit.** Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- **Konfirmim nga të tretët.** Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- **Kontrolli sipas një treguesi.** Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohej fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
- **Intervista.**
- **Raporte dhe Informacione.**
- **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK.**

**j- Dokumentimi i auditimit:** Mbështetur në ISSAI (1315), objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH<sup>ja6</sup>.

Procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në kundërshtitë, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësive shpenzuese.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

#### III/1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive. Bashkia Dibrë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Dibrë etj., akt ligjore/nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Dibrë.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Bashkia Dibrë bën pjesë në Qarkun e Dibrës.



#### Të dhëna të përgjithshme

**Zona Gjeografike:** Dibra kufizohet në veri me Bashkinë e Kukësit, në veri-perëndim me bashkinë Mirditë, në perëndim me bashkinë Mat, në jug-perëndim me bashkinë Klos, në jug me bashkinë Bulqizë dhe në lindje me Republikën e Maqedonisë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Peshkopisë.

**Popullsia:** Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia e re ka një popullsi prej 61,619 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki numëron 78,940 banorë. Me një sipërfaqe prej 937.88 km<sup>2</sup>, bashkia e re ka densitet popullsie prej 84.16 banorësh/km<sup>2</sup> sipas Regjistrat Civil dhe 65.70 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censusit 2011.

<sup>6</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit

Kjo bashki përbëhet nga 15 njësi administrative, të cilat janë: Peshkopi, Tomin, Melan, Kastriot, Lurë, Maqellarë, Muhurr, Luzni, Selishtë, Sllovë, Kala e Dodës, Zall-Dardhë, Zall-Reç, Fushë Çidhën dhe Arras. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Dibrës dhe qarkut të Dibrës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 141 fshatra.

▪ **Ndikimi i pandemisë COVID-19 në jetën ekonomike.**

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë (DPRMSH), bashkia Dibër ka përfituar ndihma ushqimore e pajisje inventari, për shkak të periudhës së pandemisë COVID-19, si dhe për pasojat që u krijuan nga tërmeti i vitit 2019. U auditua procesi që ka ndjekur bashkia për administrimin e ndihmave materiale e ushqimore të përfituara nga DPRMSH Tiranë, të cilat janë dokumentuar për çdo rast furnizimi, ndërsa janë administruar në magazinë me fletëhyrje të rregullt, bashkëlidhur së cilës është edhe fletëdalja e furnitorit. Secila fletëdalje e furnitorit (DPRMSH) është e shoqëruar me fletëhyrje në magazinën e bashkisë Dibër, ku rast pas rasti gjendja pasqyrohet sa më poshtë;

1-Fletë dalja nr.02, datë 09.05.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr.1, datë 20.07.2020.

2-Fletë dalja nr.308, datë 20.07.2020, është shoqëruar me fletëhyrje nr.2, datë 20.07.2020.

3-Fletë dalja nr.309, datë 20.07.2020, është shoqëruar me fletëhyrje nr.03, datë 20.07.2020;

4-Fletë dalja nr.310, datë 20.07.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr.04, datë 20.07.2020;

5-Fletë dalja nr.64, datë 20.07.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr.05, datë 20.07.2020;

6-Fletë dalja nr.65, datë 20.07.2020 është shoqëruar me fletëhyrje 06, date 20.07.2020;

7-Fletë dalja nr.66, datë 20.07.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr.07, datë 20.07.2020;

8-Fletë dalja nr.335, datë 26.10..2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr.08, datë 26.10.2020;

9-Fletë dalja nr.19, datë 26.10.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr.09, datë 26.10.2020;

Nga sektori i financës në bashki janë kontabilizuar të gjitha veprimet në ditarin e magazinës, duke i debituar në llogarinë përkatëse materiale.

**Në përfundim u konstatua se:** Bashkia Dibër për periudhën objekt i auditimit periodha raportuese ushtrimore viti 2020, për të gjitha rastet e furnizimeve që janë bërë nga (DPRMSH), të cilat janë të dokumentuara me fletëhyrje të rregullt për çdo rast furnizimi, nuk është konfirmuar marrja në dorëzim e të gjitha furnizimeve të bëra gjatë vitit brenda afatit 20 ditë të muajit pasardhës, veprimi në mospërputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap.(III) “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, pika 56.

## **III/2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDIMIT.**

**A-Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019 dhe 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht ligjin nr.24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMFE nr.08. datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme.**

**1. Titulli gjetjes:** Vlerësimi i Raportimit Financiar për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, të performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

### **Situata:**

Auditimi tematik u krye për vlerësimin e raportimit financiar dhe për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, japin paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë të analizuar me nënpikat sa më poshtë:

#### **-Nënpika A.1.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.**

Nga procesi i auditimit tematik mbi plotësinë dhe saktësinë e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike të ndodhura gjatë periudhës 01.01.2020 deri në 31.12.2020 në Njësia Publike Bashkia Dibër u konstatua se:

Pasqyra e pozicionit financiar në Njësia Publike Bashkia Dibër, për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 (*Formati nr.1*), pasqyrohet sipas aneksit nr.1 i depozituar në Degën e Thesarit Dibër me shkresë nr.1068 prot, datë 31.03.2021 e konfirmuar nga dega e thesarit me nr. 274 prot, datë 31.03.2021, duke respektuar afatin ligjor të përcaktuar deri në datën 31 mars të vitit pasardhës, veprim në përputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2019 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 118.

### **A. Aktivet.**

#### **I. Rubrika, aktivet afat shkurtër.**

1.Nën/rubrika, “*mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*”, gjendja Llog.(520) “**Disponibilitete në thesar**” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore, paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 64,780,168 lekë dhe më 31.12.2020 në vlerën 139.015.906 lekë, e cila përfaqëson vlerën e fondeve që trashëgohen në vitin e ardhshëm. Kjo llogari rakordon me Aktrakordimin e datës 07.01.2021 i mbajtur me Degën e Thesarit Dibër për gjendjen e fondeve në fund të periudhës ushtrimore raportuese 2020 më hollësisht sa më poshtë:

| <i>Llogaria</i>                                | <i>Vlera</i> | <i>31.12.2019</i> | <i>31.12.2020</i> |
|------------------------------------------------|--------------|-------------------|-------------------|
| Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”       |              | 64,780,268        | 139.015.906       |
| Diferenca me shtesë ka ardhur si rezultat nga; | 74,235,638   |                   |                   |
| Gjendja e mjeteve në ruajtje                   | 49,734,802   |                   |                   |
| Grande dhe të ardhura të pa përdorura          | 24,500,836   |                   |                   |

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Pasqyrat financiare.

2.Nën/rubrika “*inventarit qarkullues*”; gjendja Llog. (31) “**Materiale**” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 16,238,839 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 paraqitet në vlerën 14.880.343 lekë, vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe Aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material nga përgjegjësi sektorit dhe drejtori financës.

-Gjendja Llog.(32) “**Inventar i imët**” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore, paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 7,474,330 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 paraqitet në vlerë 8.690.670 lekë, vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në Aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit, me komisionin dhe përgjegjësin material nga përgjegjësi sektorit dhe drejtori financës.

-Gjendja Llog.(35) “**Mallra**” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore, paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 10,107,240 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020, paraqitet në vlerë 320.923 lekë, vlerë e cila përfaqësohet vetëm nga gjendja e mallrave ushqimor, vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe Aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material nga përgjegjësi sektorit dhe drejtori financës.

3.Nën/rubrika, “*Llogari të arkëtueshme*”; gjendja Llog.(423; 429) “**Personeli, paradhënie, deficite, gjoba**” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 5,915,928 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 paraqitet në vlerën 5.880.928

lekë. Në këtë llogari janë pasqyruar gjoba të ndryshme me diferencë prej 35,000 lekë e cila përfaqëson arkëtime të kryera nga gjobat, etj., ndërmjet dy periudhave raportuese ushtrimore.

-Gjendja Llog.(468) **“Debitorë të ndryshëm”** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore, paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 86,504,128 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 paraqitet në vlerën 88.410.386 lekë e cila përfaqëson detyrime të shtuara nga subjekte të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore e detyrime të rezultuara në aktkontrolle të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2020. Në mënyrë analitike paraqitet në vijim (Aneksi nr.2), konstatohet se në llog.(468) **“Debitorë të ndryshëm”** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 86,504,128 lekë dhe në datë 31.12.2020 në vlerën 88,410,386 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 kjo vlerë me analizë të hollësishme përbëhet nga;

-Debitorë për taksat e tarifat vendore në vlerën 8,619,354 lekë.

-Debitorë të rekomanduar nga KLSH në vlerën 73,085,749 lekë.

-Debitorë të kopshteve e çerdheve në vlerën 2,956,340 lekë.

-Debitorë për letrat me vlerë në shumën 3,749,281 lekë.

Kjo llog.(468) **“Debitorë të ndryshëm”** nuk rakordon për shumën 338 lekë si diferencë ndërmjet pasqyrës financiare dhe ditarit, ndërsa në këtë llogari janë nuk të pasqyruar të gjitha detyrimet debitorë të subjekteve private të lindura nga mos pagimi i nivelit të taksave e tarifave vendore, sepse nga evidentimi që bën Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore, debitorët nga subjektet taksapagues privat dhe familjar janë në vlerën prej 40,132,137 lekë, ndërsa në pasqyrat financiare paraqiten me vlerën 8,619,354 lekë, me diferencë më pak prej 31,52,783 lekë.

Në këtë mënyrë pasqyrat financiare për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e detyrimeve debitorë, veprim në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”*, aneksi 1, pika 3.3.

Gjendja Llog.(4342) **“Operacione me shtetin (të drejtat)”** (debitorë) në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 500,123,669 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 në vlerë 254,887,215 lekë me diferencë më pak vlara prej 245,236,454 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, detyrimet me analizë të hollësishme përbëhet nga:

1-detyrime për paga ndaj personelit të pasqyruara në llog.(42) *“Detyrime ndaj personelit”* në vlerë 26,543,092 lekë.

2-detyrime për sigurime shoqërore pasqyruar llog.(435) *“Sigurime shoqërore”* në vlerë 7,841,801 lekë.

3-detyrime për sigurime shëndetësore të pasqyruara në llog.(436) *“Sigurime shëndetësore”* në vlerë 1,079,280 lekë.

4-detyrimet ndaj shtetit për tatime e taksa të pasqyruara në llog.(431) *“Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa”* në vlerë 1,352,867 lekë.

5-detyrime ndaj të tretëve të pasqyruara në llog.(467) *“Kreditorë të ndryshëm”* në vlerë 189,482,772lekë.

6-detyrime nda furnitorëve të pasqyruara në llog.(401-408) *“Furnitorë e llogari të lidhura me to”* në vlerë 28,587,403 lekë.

Në total vlara për këto 6 llogari të analizuara mësipërm në pasiv është me **254,887,215 lekë**, vlerë e cila është e njëjtë me vlerën në llogarinë *“kundër parti”* e pasqyruar në llog.(4342) *“Te tjera operacione me shtetin (të drejtat) debitor”* në aktiv të bilancit, vlerë e njëjtë për këtë periudhë raportuese.

-Nga analiza e kësaj llogarie për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 për vlerën **254,887,215 lekë** përbëhet dhe është e njëjtë me shumën e llogarive si vijon:

| Nr. | EMERTIMI                                | Gjendje<br>01.01.2020 | Shtesa         | Pakësimi           | Gjendje 31.12.2020 |
|-----|-----------------------------------------|-----------------------|----------------|--------------------|--------------------|
| 1   | Paga Personeli llogaria (42)            | 30,713,000            | 0              | 4,169,908          | 26,543,092         |
| 2   | Tatim page tatim ne burim llogaria(431) | 4,589,164             | 0              | 3,236,414          | 1,352,867          |
| 3   | Sigurimet Shoqërore llogaria (435)      | 7,690,432             | 151,369        | 0                  | 7,841,801          |
| 4   | Sigurime Shëndetësore llogaria (436)    | 1,376,184             | 0              | 296,904            | 1,079,280          |
| 5   | Furnitorë llogaria.(401-408)            | 167,254,617           | 0              | 140,316,553        | 28,587,403         |
| 6   | Kreditore te ndryshëm llogaria (467)    | 288,500,272           |                | 99,017,500         | 189,482,772        |
|     | <b>TOTALI</b>                           | <b>500,123,669</b>    | <b>151,369</b> | <b>247,037,279</b> | <b>254,887,215</b> |

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Pasqyrat financiare.

Në përfundim konstatohet se; ndërmjet vlerës prej **254,887,215lekë** e pasqyruar në llog.(4342) “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës 253,237,759 lekë e pasqyruar në 6 (gjashtë) llogarit pasive, rezulton diferencë më pak shuma **1,649,456 lekë** pra në periudhën raportuese ushtrimore për vitin 2020 është më e vogël në aktiv dhe më e madhe në pasiv, pra nuk është e pasqyruar në aktiv të pasqyrave të pozicionit financiar.

4.Nën/rubrika, “të tjera aktive afatshkurtra”, gjendja Llog.(486) “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 288,500,272 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 në vlerë 189,482,772 lekë të cilat përfaqësojnë detyrimet e prapambetura të pa likuiduara ndaj të tretëve. Përbërja analitike është si në aneksin në vijim:

| Nr. | Emërtimi                                          | Vlera më 31.12.2020 |
|-----|---------------------------------------------------|---------------------|
| 1   | Detyrime për mallra.                              | 9,652,788           |
| 2   | Detyrime për shërbime.                            | 9,921,010           |
| 3   | Detyrime për vendimet gjyqësore.                  | 108,056,591         |
| 4   | Detyrime për investimet.                          | 60,186,567          |
| 5   | Detyrime për sigurimet shoqërore, ish/komunat.    | 613,891             |
| 6   | Detyrime për sigurimet shëndetësore, ish/komunat. | 252,644             |
| 7   | Detyrime për tatime te tjera.                     | 9,881               |
| 8   | Detyrime të prapambetura të tjera.                | 789,400             |
|     | <b>Totali</b>                                     | <b>189,482,772</b>  |

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Pasqyrat financiare.

Vlera prej 189,482,772 lekë e detyrimeve të prapambetura në pasqyrat e pozicionit financiar për periudhën ushtrimore raportuese rakordon me vlerën e listës së detyrimeve të prapambetura të rakorduar midis Bashkisë dhe degës së thesarit Dibër për këtë periudhë në datën 14.01.2021.

## II. Rubrika, “Aktivet afatgjata”.

1.Nën/rubrika, “aktive afatgjata jo materiale”, gjendja llog.(202) “Studime dhe kërkime”, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 35,724,228 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 40,742,260 me diferencë më tepër vlera 5,018,032 lekë e cila përfaqëson shtesën për vlerën e llog.(203) “Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme” në vlerën 12,207,842 lekë, si edhe vlerën e amortizimit i llogaritur për vitin ushtrimor 2020.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) për vitin 2020 rezulton se, është përlllogaritur amortizimi në vlerë 7,189,811 lekë e pasqyruar në formati nr.7/b “gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata”.

b) për këtë periudhë raportuese ushtrimore në llogari është pasqyruar edhe kalimi në administrim i gjendjes së llog.(203) që përfaqësohet diferencën e analizuar më sipër është me 5,018,032 lekë.

c) vlera **42,028,503 lekë** i përket 62 projekteve për investimet e kryera në objektet të cilat kanë përfunduar punimet dhe janë marrë në dorëzim nga Bashkia, vlerë e cila duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit. Në këtë rast pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë vërtetësinë e gjendjes së aktiveve, veprim në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së

*punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”, analizuar më hollësisht në (*Aneksi nr.3*), bashkëlidhur.

-Gjendja llog.(203) **“Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme”** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 12,207,842 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 paraqitet me vlera 0 (zero) e cila për vitin 2020 përfaqëson veprimet e transferimit me administrim në llog.(202) **“Studime dhe kërkime”**. Në këtë llogari ishte e pasqyruar vlera për 17 projekte të hartuara nga subjekte të ndryshme private me procedurë dhurimi, ndërsa nga Bashkia nuk janë të administruara me dokumente dhurimi.

*Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:*

**a)** Vlera prej 14,362,167 lekë i përket 17 projekteve në investimet e kryera për objekte të cilat kanë përfunduar punimet dhe nga Bashkia janë marrë në dorëzim, nuk është kryer veprimi për të sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit. Për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare nuk e pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi në mospërputhje me UKM nr.2, datë 08.05.2003 **“Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”**, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b” të evidentuara në (*Aneksi nr.4*), bashkëlidhur. Sektori i financës për këtë llogari, nuk ka respektuar kërkesat e akteve nënligjore të parashikuara nga UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 **“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”**, aneksi 1, klasa 2, pika (2.1), pika 36, paragrafi (4); UKM nr.2, datë 08.05.2003 **“Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”** i ndryshuar, pika c, nën pika (b).

**b)** për vitin 2020 rezulton se, pasi është bërë transferimi në llog.(202) është përlllogaritur amortizimi për këto projekte ta administruara në llogarinë përkatëse i evidentuar në formati nr.7/b **“gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata”**.

## 2.Nën rubrika, “Aktive afatgjata materiale”;

-Gjendja llog.(210) **“Toka, Troje, Terrene”** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 28,394,404 lekë, vlerë kjo e pa ndryshuar edhe në datën 31.12.2020. Në këtë llogari pasqyrohet vlerat e investimeve të kryera ndër vite, kryesisht për shpronësim truall Shkolla e Mesme, Konvikti shpronësim rruge tek gjimnazi i ri.

*Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:*

Në llog.(210) **“Toka, Troje, Terrene”** nuk është e pasqyruar:

**a)** Vlera e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të konvikteve, godina e Bashkisë, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj., sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llog.(212) **“Ndërtime e konstruksione”**, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 9.03.2018 **“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”**, Kap.(II), pika 11, aneksi 1, pika 2 klasa 2.

**b)** Vlerat e trojeve të cilat kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Dibër, përkatësisht me VKM nr.1533, datë 19.11.2008 **“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Peshkopi, qarku Dibër”**; VKM nr.1179, datë 20.08.2008 **“Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në Komunën Melan, të qarkut të Dibrës”**; VKM nr.1001 datë 10.12.2010 **“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Arras, të qarkut të Dibrës”**, veprim në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 **“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”**, pika 30,



c) Nuk është kryer inventarizimi fizik dhe vlerësimi i trojeve me komision të ngritur nga titullari i njësisë vendore, veprim në mospërputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. IV, pikat 74; 96, me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. II, pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 30, UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Gjendja llog.(211) “**Pyje, kullota, plantacione**” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 1,268,000 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerën 2,468,000 lekë me shtesë 1,200,000 lekë. Në këtë llogari është pasqyruar edhe vlera e investimeve të kryer për “ndërtim lere” në vlerën 1,200,000 lekë për gjatë vitit 2020, ndërsa duhet të administrohet në llog.(213) “.....vepra ujqor”, sa më poshtë:

| Nr. | Përshkrimi i aktivitetit        | Vlera     |
|-----|---------------------------------|-----------|
| 1   | Ndërtim lere uji për blegtorinë | 1,200,000 |

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Pasqyrat financiare.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) Në llog.(211) “Pyje, kullota, plantacione” nuk është pasqyruar vlera e pyjeve e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Dibër me VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 8, shtojca nr.6 me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Dibër, nga nr.1(një) deri 2327 (dymijë e treqind e njëzet e shtatë). Sipas këtij vendimi Bashkia Dibër ka në pronësi gjithsej **36,662** ha nga të cilët 25,351 ha pyje; 5,412 ha kullota, 534 ha sipërfaqe me bimësi pyjore, 3,417 ha sipërfaqe inproduktive, 1,889 ha sipërfaqe djerr dhe 57 ha sipërfaqe ujore. Veprim në mospërputhje me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 klasa 2.

b) Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi Pyjeve e Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit. Llog.(211) “Pyje, kullota, plantacione” nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UMFE nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap IV, pikat 74, 96. UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. II, pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2; UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,

-Gjendja llog.(212) “**Ndërtime e konstruksione**” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 949,002,810 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerën 901,645,234 lekë me diferencë vlera 47,357,576 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera gjatë vitit për ndërtime e rikonstruksione në vlerë 97,436 lekë, si dhe paksime për vlerë 47,455,012 lekë e amortizimit vjetor.

Për vitin 2020 është përdorur norma e amortizimit 5%

| Nr. | Vlera në çelje (vlera neto) | Shtesa gjatë vitit 2020 | Vlera para amortizimit | Amortizimi | Vlera neto më 31.12.2020 |
|-----|-----------------------------|-------------------------|------------------------|------------|--------------------------|
| 1   | 949,002,810                 | 97,436                  | 949,100,246            | 47,455,012 | 901,645,234              |

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Pasqyrat financiare.

Nga analiza e llog.(212) “Ndërtim e konstruksione”, bazuar në listën e aktiveve afat gjata materiale në mënyrë analitike pasqyron (Aneksi nr.5) bashkëlidhur, konstatohet se:

**a)** Nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë, që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksionit të objekteve, vlera mbikëqyrjes e kolaudit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë kosto të mëpasshme duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM<sup>-së</sup>. Investimet në total shtesë deri në 31.12.2020, janë në vlerën 422,160,312 lekë për 22 objekte të evidentuar sipas aneksit nr.5, bashkëlidhur. Veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes Përgjithshme”, Kap. II, pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, germa ‘b’.

**b)** Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, veprim në mospërputhje me ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, pika 1; 2, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. IV, pika 74; 96 dhe UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36, paragraf (4); Kap. II, pika 11, Aneksi 1, pika 2, Klasa 2 “Aktivet afat gjata”, përbërja dhe trajtimi kontabël, germa (b); ligji nr.25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15.

-Gjendja llog.(213) “Rrugë, rrjete vepra ujore” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 3,311,844,643 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 në vlerë 3,220,890,606 lekë me diferencë vlera 90,954,037 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite në rrugë, rrjete e vepra ujore si dhe shtesat e pakësimet vetëm për vlerën e amortizimit gjatë periudhës.

*Për vitin 2020 është përdorur norma e amortizimit 5%*

| Vlera në çelje | Shtesa gjatë vitit 2020 | Vlera para amortizimit | Amortizimi  | Vlera neto më 31.12.2020 |
|----------------|-------------------------|------------------------|-------------|--------------------------|
| 3,311,844,643  | 77,432,190              | 3,389,276,833          | 168,386,227 | 3,220,890,606            |

*Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Pasqyrat financiare*

Llogaria (213) “Rrugë, rrjete vepra ujore” bazuar dhe në listën e aktiveve afat gjata materiale në mënyrë analitike paraqitet me gjendjen e mësipërme.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;

**a)** Në përlllogaritjen e amortizimit vjetor të aktiveve afatgjata për periudhën raportuese ushtrimore 2020 në vlerën 168,386,227 lekë rezulton se norma mesatare vjetore është përlllogaritur me 5%, duke respektuar normën e amortizimit, veprim në përputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes Përgjithshme”, pika 36.

**b)** Nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme, duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM<sup>-së</sup>. Investimeve shtesë deri në 31.12.2020 janë në vlerën 1,338,990,402 lekë, për 218 raste sipas (Aneksit nr.6), bashkëlidhur, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. II, pika 11, Aneksi 1, pika 2 Klasa 2, germa ‘b’.

**c)** Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM<sup>-ve</sup> me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, veprim në mospërputhje me ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin

dhe pasqyrat financiare”, neni 15, pikat 1 dhe 2; UMFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap.(IV), pika 74 dhe 96; UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36, -UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(II), pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, “Aktivet afat gjata”, përbërja dhe trajtimi kontabël, germa (b), -Ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15,

-Gjendja llog.(214) **“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 89,740,024 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerën 87,586,063 lekë me diferencë për 2,153,961 lekë e cila përfaqëson vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite, shtesat gjatë periudhës dhe pakësimet nga amortizimi për periudhën raportuese ushtrimore.

-Gjendja llog.(215) **“Mjete transporti”** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 35,123,424 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerën 34,745,273 lekë me diferencë për 378,151 lekë e cila përfaqëson vlerën e mjeteve ndër vite, shtesat gjatë periudhës dhe pakësimet nga amortizimi për periudhën raportuese ushtrimore.

*Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:*

**a)** Në llog.(215) **“Mjete transporti”** të pasqyrave të pozicionit financiar të vitit 2020 e cila paraqitet në vlerën 34,745,273 lekë është pasqyruar gabim edhe vlera prej 10,061,498 lekë për 8 (tetë) mjete transporti në gjendje të dëmtuara, pra është kryer kontabilizimi i gabuar në llog.(215) **“Mjete Transporti”**, ndërsa në fakt duhej të ishin të regjistruara dhe kontabilizuar në llog.(24) **“Aktive afatgjata të dëmtuara”** për 8 (tetë) mjete transporti të cilat nuk janë në gjendje pune, por të dëmtuar të evidentuara në (Aneksi nr.7), bashkëlidhur.

**b)** Amortizimi është llogaritur në vlerën 1,767,751 lekë në masë 5% sipas (Aneksit nr.8) bashkëlidhur, veprim në përputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(II), pika 11, aneksi 1, pika 2/1, germa (e); pika 36.

Për vitin 2020 është përdorur norma e amortizimit 5%

| Vlera në çelje | Shtesa gjatë vitit 2020 | Vlera para amortizimit | Amortizimi | Vlera neto më 31.12.2020 |
|----------------|-------------------------|------------------------|------------|--------------------------|
| 35,123,424     | 1,389,600               | 36,513,024             | 1,767,751  | 34,745,273               |

*Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Pasqyrat financiare*

-Gjendja llog.(218) **“Inventar ekonomik”** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 133,463,193 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerën 129,206,822 lekë me diferencë për 4,256,371 lekë e cila përfaqëson vlerën e shpenzimeve të kryera ndër vite dhe shtesat gjatë vitit 2020, sipas listës analitike të sektorit të financës.

Nga analiza e kësaj llogarie për vitin 2019 konstatohet se: Gjendja llog.(218) **“Inventar ekonomik”**, në datë 31.12.2020 është përllogaritur nga Bashkia.

| Vlera në çelje 01.01.2020 | Shtesa gjatë vitit 2019 | Vlera para amortizimit | Amortizim akumuluar | Amortizimi vjetor | Amortizimi total | Vlera neto 31.12.2020 |
|---------------------------|-------------------------|------------------------|---------------------|-------------------|------------------|-----------------------|
| 133,463,193               | 2,464,152               | 135,927,345            | 8,730,047           | 6,720,523         | 15,450,570       | 129,206,822           |

*Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Pasqyrat financiare*

3.Nën/rubrika, aktive afatgjata financiare, ku bënë pjesë referenca llog.(25) “Huadhënie e nenhuadhënie” dhe 6 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, ndërsa nuk janë kryer veprime të tilla, për rrjedhojë edhe gjendja e tyre në pasqyrat e pozicionit financiar paraqitet me 0 (zero).

#### 4.Nënrubrika, Investime.

-Gjendja llog.(230) **“Aktive afatgjata jo materiale”**, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 11,223,596 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerën 18,131,232 lekë me diferencë për 6,907,636 lekë e cila përfaqëson vlerën e studime e projekte për investimet në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor, ndërsa do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre, kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë në llogaritë të Klasës (2) **“Aktive afat gjata materiale”**.

*Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:*

a) Sektori financës ka të analizuar e dokumentuar në mënyrë analitike e justifikuese vlerën e pasqyruar të pozicionit financiar vetëm për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 për 4 objekte me vlerë 6,907,636 lekë, ndërsa për periudhat paraardhëse nuk disponohet asnjë analizë dhe dokument justifikues, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 **“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”**, Kap.(II), pikat 6; 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi; **“Trajtimi kontabël dhe funksionimi grupi (20) "Aktive afatgjata jomateriale" dhe pika 18.**

-Gjendja llog.(231) **“Për aktive afatgjata materiale”** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 215,232,725 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerën 545,659,534 lekë me diferencë për 330,426,810 lekë e cila përfaqëson vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre, kur ato të kthehen aktive dhe kalojnë te llogaritë Klasa (2) **“Aktive afat gjata materiale”**. *Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:*

a) Sektori financës ka të analizuar e dokumentuar në mënyrë justifikuese vlerën e pasqyruar të pozicionit financiar vetëm për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 për 5 objekte me vlerë 330,426,810 lekë, ndërsa për periudhat paraardhëse nuk disponohet asnjë analizë dhe dokument justifikues, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 **“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”**, Kap.(II), pikat 6; 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi; **“Trajtimi kontabël dhe funksionimi grupi (20) "Aktive afatgjata jomateriale" dhe pika 18.**

## II. Rubrika, pasivet afat shkurtra.

**1.Nënrubrika, llogari të pagueshme, gjendja e llog.(401-408) “Furnitorë dhe llogari te lidhura me to”**, të llog.(42) **“Personeli e llogari të lidhura me to”**, të llog.(431) **“Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”**, të llog.(435) **“Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”**, të llog.(436) **“Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”**, të llog.(467) **“Kreditore te ndryshëm”**, janë të barabarta me gjendjen e llog.(4342) **“Operacione me shtetin”** në vlerën prej 254,887,215 lekë për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, e analizuar përbëhet dhe është e njëjtë me shumën e llogarive si vijon:

| NR | EMERTIMI                             | Gjendje 01.01.2020 | Shtesa         | Pakësimi           | Gjendje 31.12.2020 |
|----|--------------------------------------|--------------------|----------------|--------------------|--------------------|
| 1  | Paga Personeli llog.(42)             | 30,713,000         | 0              | 4,169,908          | 26,543,092         |
| 2  | Tatim page tatim ne burim llog.(431) | 4,589,164          | 0              | 3,236,297          | 1,352,867          |
| 3  | Sigurimet Shoqërore llog.(435)       | 7,690,432          | 151,369        | 0                  | 7,841,801          |
| 4  | Sigurime Shëndetësore llog.(436)     | 1,376,184          | 0              | 296,904            | 1,079,280          |
| 5  | Furnitorë llog.(401-408)             | 172,709,744        | 0              | 144,122,341        | 28,587,403         |
| 6  | Kreditore te ndryshëm llog.(467)     | 288,500,272        | 0              | 99,017,500         | 189,482,772        |
|    | <b>TOTALI</b>                        | <b>500,123,669</b> | <b>151,369</b> | <b>250,842,450</b> | <b>254,887,215</b> |

*Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Pasqyrat financiare*

Nga analiza e këtyre llogarive rezulton se: ndërmjet vlerës e pasqyruar në llog.(4342) **“Operacione me shtetin, të drejta”** dhe vlerës e pasqyruar në 6 (gjashtë) llogarit pasive për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, nuk rezulton diferencë, ndërsa e njëjta vlerë është e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

-Gjendja llog.(401-408) **“Furnitorë e llogari të lidhura me to”**, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 172,709,744 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerën 28,587,403 lekë me diferencë për 144,122,341 lekë e cila përfaqëson detyrimet e Bashkisë ndaj të tretëve.

*Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:* Vlera prej **28,587,403 lekë** e pasqyruar gjendje në datën 31.12.2020 është e justifikuar me dokumente analitike me të dhëna pasqyruar në (Aneksi nr.9) bashkëlidhur.

**Për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020.**

-Gjendja llog.(42) **“Detyrime ndaj personelit”** gjendje në datë 31.12.2020 paraqitet në vlerë 26,543,092 lekë e cila paraqet detyrimet për pagat e punonjësve për muaji dhjetor 2020 të kuadruara me dega e thesarit Dibër dhe të likuiduara në janar 2021.

-Gjendja llog.(431) **“Detyrime ndaj shtetit tatim taksa”** gjendje në datë 31.12.2020 paraqitet në vlerë 1,352,867 lekë e cila paraqet detyrimet për tatim mbi të ardhurat të punonjësve për muaji dhjetor 2020 të kuadruara me dega e thesarit Dibër dhe të likuiduara në janar 2021.

-Gjendja llog.(435) **“Sigurime shoqërore”** në 31.12.2019 gjendje në datë 31.12.2020 paraqitet në vlerë 7,841,801 lekë e cila paraqet detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore të punonjësve për muaji dhjetor 2020 të kuadruara me dega e thesarit Dibër dhe të likuiduara në janar 2021.

-Gjendja llog.(436) **“Sigurime shëndetësore”** gjendje në datë 31.12.2020 paraqitet në vlerë 1,079,280 lekë e cila paraqet detyrimet për kontributin e sigurimeve shëndetësore të punonjësve për muaji dhjetor 2020 të kuadruara me dega e thesarit Dibër dhe të likuiduara në janar 2021. Të krahasuara me lista pagesat e muajit dhjetor të vitit 2020 dhe me evidencën e shpenzimeve të muajit janar të vitit 2021, vlerat e llog.(42; 431; 435; 436) rakordojnë dhe janë të njëjta me përmbledhësen e listë pagesave dhe evidencën e shpenzimeve.

-Gjendja llog.(466) **“Kreditorë për mjete në ruajtje”**, gjendje në datë 31.12.2020 paraqitet në vlerën 49,734,802 e cila përfaqëson ngurtësimin si detyrime të Bashkisë ndaj operatorëve ekonomik për 5% garanci në punimet e objekte të ndryshme të përfshirë ndër vite.

Gjatë periudhës raportuese ushtrimore viti 2020, Sektori financës ka dokumentuar ngurtësime në vlerën 19,872,954 lekë për 12 operator ekonomik, ndërsa ka kryer likuidime në vlerën 4,792,686 lekë për 4 operator ekonomik. Bashkia me degën e thesarit Dibër në datë 09.02.2021 ka mbajtur Aktrakordimin përkatësisht:

a) për 5% ngurtësime progresive në vlerën 19,872,954 lekë deri më 31.12.2020.

b) për 5% e likuidimeve progresive në vlerën 4,792,686 lekë deri më 31.12.2020.

Ndërmjet vlerës së ngurtësimeve në vlerën 19,872,954 lekë dhe likuidimeve në vlerën 4,792,686 lekë, rezulton një diferencë në vlerë 15,080,268 lekë e cila përfaqëson gjendjen e llog.(466) **“Kreditorë për mjete në ruajtje”** në datën 31.12.2020 për detyrime të krijuara gjatë vitit ushtrimor 2020, të pasqyruara më hollësisht në (Aneksat nr.10; nr.11 dhe nr.12), bashkëlidhur.

**Si përfundim konstatohet se:** Në llog.(466) **“Kreditorë për mjete në ruajtje”** gjendje më datë 31.12.2020 paraqitet në vlerën 49,734,802 lekë, e cila përfaqëson detyrimet e Bashkisë ndaj operatorëve ekonomik për garanci në punime për objekte të përfunduara, si edhe për ato në proces.

- garancia e trashëguar nga periudhat paraardhëse vlera 34,654,534 lekë.

- diferenca e krijuar ndërmjet likuidimet dhe garancisë në vlerën 15,080,268 lekë periudha 2020

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se:

**a)** Në pasqyrat e pozicionit financiar llog.(466) “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në vlerë 49,734,802 lekë e cila rakordon me gjendjen e pasqyruar, ndërsa nuk është e analizuar në mënyrë analitike për çdo objekt ndërtimi dhe operator ekonomik, si pasojë e mos pasqyrimit në Aktrakordin dhe në evidencat analitike për të gjithë operatorët ekonomik që Bashkia ka detyrim në lidhje me vlerën e garancisë për punimet e përfunduara, apo ato në proces.

**b)** Për 33 objekte të përfunduara e të marra në dorëzim nga Bashkia që pasqyrohet në vlerën 13,013,172 lekë, sipas aneksit përkatës nuk është bërë zhbllokimi i vlerës, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në degën e Thesarit, megjithëse është përmbushur afati garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Veprime në mospërputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(III), pikat 30;50, UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

#### **-Në pasiv të bilancit pasqyrohet:**

-Llog.(467) “**Kreditorë të ndryshëm**” paraqitet gjendje në datën 31.12.2020 në vlerën 189,482,772 lekë që përputhet me vlerën e pasqyruar në llog.(486) “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2020 në vlerën 189,482,772 lekë e cila përfaqëson vlerat për fatura të pa likuiduara ndaj të tretëve. Nga auditimi rezulton se, detyrimet e prapambetura për faturat e pa likuiduara për investime, blerje mallra, shërbime, vendime gjykate, etj. të trajtuara tek pika për ri-auditimin e treguesve të buxhetit të bashkisë e pasqyruar me gjendje në datën 31.12.2020 në vlerën 218,856,175 lek, ndërsa në pasqyrat financiare detyrimet e pa likuiduara paraqiten të pasqyruara në llog.(467) “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 189,482,772 lekë, si detyrime të pa likuiduara ndër vite dhe deri në datë 31.10.2020, si dhe në llog.(401-408) “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 28,587,403 lekë si detyrime të krijuara për likuidim në periudhën 60 (ditë) deri në përfundim të periudhës raportuese ushtrimore viti 2020. Vlera e detyrimeve të prapambetura në vlerën 218,856,175 lekë sipas natyrës së detyrimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Nr.          | Emërtimi i natyrës së detyrimit                                 | Vlera e detyrimit më 31.12.2020 |
|--------------|-----------------------------------------------------------------|---------------------------------|
| 1            | Detyrim për investimet                                          | 77,599,018                      |
| 2            | Detyrim për vendimet gjyqësore                                  | 108,056,591                     |
| 3            | Detyrim për mallra dhe shërbime                                 | 32,334,031                      |
| 4            | Detyrime të prapambetura për sigurimet shoqërore, ish komnat    | 613,891                         |
| 5            | Detyrime të prapambetura për sigurimet shëndetësore, ish komnat | 252,644                         |
| <b>Total</b> |                                                                 | <b>218,856,175</b>              |

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Dibër

-Llog.(4341) “**Operacione me shtetin (detyrime)**” në fund të periudhës raportuese ushtrimor viti 2020, paraqitet me vlerë 94,291,314 lekë e cila përfaqëson detyrimet debitorë të cilat i përkasin buxhetit të shtetit. Këto detyrime në aktivin e bilancit paraqiten në llog.(468) “Debitorë të ndryshëm” e cila është në vlerën 88,410,386 lekë e trajtuar në aktiv të pasqyrave të pozicionit financiar, si edhe në llog.(423) “Personeli, paradhënie, gjoba” në vlerën 5,880,928 lekë.

### **-Pasqyrat e konsoliduar në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë.**

Bashkia Dibër për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, nuk ka hartuar pasqyrat e konsoliduar në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë, për të dhënë një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet dhe fluksin e mjeteve monetare.

Në vartësi të njësisë publike Bashkia Dibër janë 4 (katër) Njësi publike vartësie konkretisht:

*-Njësia Ekonomike, Qendra Balneare Peshkopi,*

*-Njësia Ekonomike, Qendra Kulturore Dibër,*

*-Njësia Ekonomike, Shumesportesh Dibër,*

*-Njësia Ekonomike, Klubi i Futbollit Dibër.*

Për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020, njësi e ekonomike në vartësi të Bashkisë Dibër, pasqyrat e pozicionit financiar i kanë dorëzuar në degën e thesarit Dibër, ndërsa nuk kanë dorëzuar në Drejtorinë Ekonomike në Sektorin e Financës të Bashkisë Dibër, veprim në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”; neni 9, pika 4, germa (d), neni 12 pika 2, germa (b); UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes Përgjithshme”, Kap.(II), pikat 98; 99; 100; 101, germa (b), pika 118.

*Për veprimet e mos veprimet në lidhje me mangësitë në vlerësimin e raportimit financiar për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020 për paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi trajtuar më hollësisht në aktkonstatim.*

#### **Kriteri:**

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare,

Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe zbatimi i rregullores “Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore”.

VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;

VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 46, shtojca me nr.44,

VKM nr.1533, datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Peshkopi, të qarkut të Dibrës”,

VKM nr.1179, datë 20.08.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në Komunën Melan, të qarkut të Dibrës”,

VKM nr.1001 datë 10.12.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Arras, të qarkut të Dibrës”.

UKM nr.3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësi e të Qeverisjes së Përgjithshme”,

UMFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

#### **Ndikimi/efekti:**

Pasqyrat financiare të periudhës raportuese ushtrimore viti 2020 nuk paraqesin informacion të saktë për disa llogari konkretisht; llog.(468; 210; 211; 212; 215; 230; 231; 466), nuk pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore të Bashkisë Dibër.

#### **Shkaku:**

Mos zbatim i kërkesave ligjore

## **Rëndësia: E lartë**

### **Rekomandimi:**

Titullari bashkisë në cilësinë Nënpunësit autorizues dhe Drejtori Financës në cilësinë Nënpunësit zbatues, të marrin masa për të sistemuar vlerat e llogarive përkatëse konkretisht; (468); (210); (211); (212); (215); (230-231); (466), të cilat nuk e pasqyrojnë me vërtetësi vlerën e saktë të pasurisë së njësisë publike vendore Bashkia Dibër, duke bërë që në këto llogari në fund të vitit ushtrimor raportues të paraqitet vlera e saktë gjendje.

***-Nënpika A.1.2. Vlerësimi arsyeshëm e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme);***

***-Nënpika A.1.3. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nënnjesisë.***

**2. Titulli gjetjes:** Vlerësimi i arsyeshëm mbi plotësinë, saktësinë dhe vlerësimin e ngjarjeve ekonomike, si kryerja e inventarizimeve fizike të aktiveve, saktësia e kthimit të përgjigjeve ndaj donatorëve për furnizime të ndryshme prej tyre

### **Situata:**

Në lidhje plotësinë dhe saktësinë në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike, u krye auditimi i disa testimeve të ngjarjeve ekonomike që u vlerësuan si të domosdoshme për të dhënë një paraqitje të vërtetë e të drejtë të opinionit për pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2019. Testet e kryera janë si në vijim:

### **a-Mbi administrimin e ndihmave ushqimore në Bashkinë Dibër, të furnizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit (DPRMSH).**

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë (DPRMSH), bashkia Dibër ka përfituar ndihma ushqimore e pajisje inventari, për shkak të periudhës së pandemisë COVID-19, si dhe për pasojat që u krijuan nga tërmeti i vitit 2019. U auditua procesi që ka ndjekur bashkia për administrimin e ndihmave materiale e ushqimore të përfituara nga DPRMSH Tiranë, të cilat janë dokumentuar për çdo rast furnizimi, ndërsa janë administruar në magazinë me fletëhyrje të rregullt, bashkëlidhur së cilës është edhe fletëdalja e furnitorit. Secila fletëdalje e furnitorit (DPRMSH) është e shoqëruar me fletëhyrjen e bashkisë Dibër, ku për rast pas rasti gjendja pasqyrohet sa më poshtë;

- 1-Fletëdalja nr.02, datë 09.05.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr.1, datë 20.07.2020.
- 2-Fletëdalja nr.308, datë 20.07.2020, është shoqëruar me fletëhyrje nr.2, datë 20.07.2020.
- 3-Fletëdalja nr.309, datë 20.07.2020, shoqëruar me fletëhyrje nr.03, datë 20.07.2020;
- 4-Fletëdalja nr.310, datë 20.07.2020 shoqëruar me fletëhyrje nr.04, datë 20.07.2020;
- 5-Fletëdalja nr.64, datë 20.07.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr.05, datë 20.07.2020;
- 6-Fletëdalja nr.65, datë 20.07.2020 shoqëruar me fletëhyrje 06, date 20.07.2020;
- 7-Fletëdalja nr.66, datë 20.07.2020 shoqëruar me fletëhyrje nr.07, datë 20.07.2020;
- 8-Fletëdalja nr.335, datë 26.10..2020 shoqëruar me fletëhyrje nr.08, datë 26.10.2020;
- 9-Fletëdalja nr.19, datë 26.10.2020 shoqëruar me fletëhyrje nr.09, datë 26.10.2020;

Spektori financës në bashki ka kontabilizuar të gjitha veprimet në ditarin e magazinës, duke e debituar llogarinë përkatëse materiale.

### **Në përfundim konstatohet se:**

Nga bashkia Dibër për periudhën objekt auditimi viti 2020, për të gjitha rastet e furnizimeve që janë bërë nga (DPRMSH), të cilat janë të dokumentuara me fletëhyrje të rregullt për çdo



rast furnizimi, nuk është konfirmuar marrja në dorëzim e të gjitha furnizimeve të bëra gjatë vitit brenda afatit 20 ditë të muajit pasardhës, veprimi në mospërputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap.(III) “Regjistri aktiveve e dokumentimi lëvizjes tyre, Marrja dorëzim e aktiveve të furnizuara”, pika 56.

**b-Transaksionet financiare për pagat, tatimin mbi pagë, kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.**

U auditua procedura në lidhje me përllogaritjen e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, ndërsa u përzgjedh perioda 3/mujori III e vitit 2020, për strukturën (Aparati) ku rezultoi se; referuar në listë pagesat e vitit 2020 për muajt (Korrik-Gusht-Shtator 2020), të cilat janë të pasqyruara edhe në përmbledhësen e listë pagesave të çdo muaji në lidhje me përllogaritje e detyrimeve për tatimin mbi pagë, detyrimi për sigurime shoqërore e shëndetësore, si dhe urdhër shpenzimet për likuidimin e detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe organeve tatimore, ndërsa përllogaritja e detyrimeve dhe pagesat e tyre paraqiten sa më poshtë:

***Pagat sipas listë pagesave për muajin Korrik 2020***

| Nr.           | Prog | Emërtimi | Page Neto        | Tatimi         | sigurime shoqërore + suplementare | Sigurime shëndetësore |
|---------------|------|----------|------------------|----------------|-----------------------------------|-----------------------|
| 1             | 1110 | APARATI  | 6.400.733        | 390.264        | 1.883.891                         | 260.942               |
| <b>TOTALI</b> |      |          | <b>6.400.733</b> | <b>390.264</b> | <b>1.883.891</b>                  | <b>260.942</b>        |

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Dibër

***Urdhër shpenzimet e bankës për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin për muajin Korrik 2020***

| nr. USH       | date       | Objekti i shpenzimit            | Llog 421         | Llog 431       | Llog 435         | Llog 436       |
|---------------|------------|---------------------------------|------------------|----------------|------------------|----------------|
| 632           | 04.08.2020 | Pagat e muajit Korrik 2020      | 36.115           |                |                  |                |
| 633           | 04.08.2020 | Pagat e muajit Korrik 2020      | 2.101.285        |                |                  |                |
| 637           | 04.08.2020 | Pagat e muajit Korrik 2020      | 1.096.277        |                |                  |                |
| 644           | 04.08.2020 | Pagat e muajit Korrik 2020      | 106.987          |                |                  |                |
| 645           | 04.08.2020 | Pagat e muajit Korrik 2020      | 343.483          |                |                  |                |
| 661           | 07.08.2020 | Pagat e muajit Korrik 2020      | 2.386.445        |                |                  |                |
| 667           | 07.08.2020 | Pagat e muajit Korrik 2020      | 36.327           |                |                  |                |
| 668           | 07.08.2020 | Pagat e muajit Korrik 2020      | 90.382           |                |                  |                |
| 680           | 17.08.2020 | Pagat e muajit Korrik 2020      | 203.432          |                |                  |                |
| 686           | 18.08.2020 | Tatim + sig shoq., shend+suplem |                  | 390.264        | 1.883.891        | 260.942        |
| <b>TOTALI</b> |            |                                 | <b>6.400.733</b> | <b>390.264</b> | <b>1.883.891</b> | <b>260.942</b> |

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Dibër

***Pagat sipas listë pagesave për muajin Gusht 2020***

| Nr.           | Prog | Emërtimi | Page Neto        | Tatimi         | sigurime shoqërore +suplementare | Sigurime shëndetësore |
|---------------|------|----------|------------------|----------------|----------------------------------|-----------------------|
| 1             | 1110 | APARATI  | 6.589.518        | 396.531        | 1.922.493                        | 266.298               |
| <b>TOTALI</b> |      |          | <b>6.589.518</b> | <b>396.531</b> | <b>1.922.493</b>                 | <b>266.298</b>        |

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Dibër

***Urdhër shpenzimet e bankës për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin për muajin Gusht 2020***

| nr. USH       | date       | Objekti i shpenzimit             | Llog 421         | Llog 431       | Llog 435         | Llog 436       |
|---------------|------------|----------------------------------|------------------|----------------|------------------|----------------|
| 721           | 01.09.2020 | Pagat e muajit Gusht 2020        | 36.115           |                |                  |                |
| 729           | 02.09.2020 | Pagat e muajit Gusht 2020        | 2.124.596        |                |                  |                |
| 733           | 02.09.2020 | Pagat e muajit Gusht 2020        | 1.070.651        |                |                  |                |
| 737           | 02.09.2020 | Pagat e muajit Gusht 2020        | 343.483          |                |                  |                |
| 738           | 02.09.2020 | Pagat e muajit Gusht 2020        | 109.709          |                |                  |                |
| 746           | 03.09.2020 | Pagat e muajit Gusht 2020        | 82.649           |                |                  |                |
| 751           | 04.09.2020 | Pagat e muajit Gusht 2020        | 2.343.746        |                |                  |                |
| 752           | 04.09.2020 | Pagat e muajit Gusht 2020        | 2.260            |                |                  |                |
| 757           | 04.09.2020 | Pagat e muajit Gusht 2020        | 53.280           |                |                  |                |
| 765           | 10.09.2020 | Pagat e muajit Gusht 2020        | 423.029          |                |                  |                |
| 786           | 18.09.2020 | Tatim + sig shoq., shend+suplem. | 0                | 396.531        | 1.922.493        | 266.298        |
| <b>TOTALI</b> |            |                                  | <b>6.589.518</b> | <b>396.531</b> | <b>1.922.493</b> | <b>266.298</b> |

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Dibër

***Pagat sipas listë pagesave për muajin Shtator 2020***

| Nr.           | Prog | Emërtimi | Page Neto        | Tatimi         | sigurime shoqërore + suplementare | Sigurime shëndetësore |
|---------------|------|----------|------------------|----------------|-----------------------------------|-----------------------|
| 1             | 1110 | APARATI  | 6.704.351        | 406.181        | 1.982.881                         | 274.678               |
| <b>TOTALI</b> |      |          | <b>6.704.351</b> | <b>406.181</b> | <b>1.982.881</b>                  | <b>274.678</b>        |

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Dibër

***Urdhër shpenzimet e bankës për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin për muajin Shtator 2020***

| nr. USH | date       | Objekti i shpenzimit       | Llog 421  | Llog 431 | Llog 435 | Llog 436 |
|---------|------------|----------------------------|-----------|----------|----------|----------|
| 816     | 05.10.2020 | Pagat e muajit Shtator2020 | 36.115    |          |          |          |
| 823     | 05.10.2020 | Pagat e muajit Shtator2020 | 1.006.785 |          |          |          |

| nr. USH       | date       | Objekti i shpenzimit            | Llog 421         | Llog 431       | Llog 435         | Llog 436       |
|---------------|------------|---------------------------------|------------------|----------------|------------------|----------------|
| 824           | 05.10.2020 | Pagat e muajit Shtator2020      | 343.483          |                |                  |                |
| 825           | 05.10.2020 | Pagat e muajit Shtator2020      | 2.195.251        |                |                  |                |
| 826           | 05.10.2020 | Pagat e muajit Shtator2020      | 109.709          |                |                  |                |
| 841           | 07.10.2020 | Pagat e muajit Shtator2020      | 46.348           |                |                  |                |
| 861           | 07.10.2020 | Pagat e muajit Shtator2020      | 82.649           |                |                  |                |
| 864           | 08.10.2020 | Pagat e muajit Shtator2020      | 53.280           |                |                  |                |
| 867           | 08.10.2020 | Pagat e muajit Shtator2020      | 2.382.424        |                |                  |                |
| 869           | 08.10.2020 | Pagat e muajit Shtator2020      | 32.368           |                |                  |                |
| 870           | 08.10.2020 | Pagat e muajit Shtator2020      | 415.939          |                |                  |                |
| 905           | 15.10.2020 | Tatim +sigshoq., shend+ suplem. |                  | 406.181        | 1.982.881        | 274.678        |
| <b>TOTALI</b> |            |                                 | <b>6.704.351</b> | <b>406.181</b> | <b>1.982.881</b> | <b>274.678</b> |

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Dibër

Njëkohësisht u auditua procedura dhe transaksioni financiar në lidhje me pagat, tatimin mbi pagë, kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore për muajin dhjetor 2020, për të cilat likuidimi bëhet në muajin janar viti 2021, ku rezultoi se; Sipas listë pagesave të muajit dhjetor viti 2020 detyrimet për paga ndaj personelit për (aparati) janë në vlerë 7,927,288 lekë, ku nga përlllogaritjet rezultojnë se kontributi për sigurime shoqërore e suplementare zë vlerën 2,315.855 lekë, për sigurime shëndetësore zë vlerën 320.888 lekë dhe për tatim mbi të ardhurat zë vlerën 267,304 lekë, të cilat janë likuiduar në muaji janar viti 2021 sipas urdhër shpenzimeve përkatëse në vlerat e përcaktuara sa më poshtë;

| NR.           | EMERTIMI                        | Dhjetor 2020      |
|---------------|---------------------------------|-------------------|
| 1             | Paga Personeli (421)            | 7.927.288         |
| 2             | Tatim page tatim ne burim (431) | 267.304           |
| 3             | Sigurimet Shoqërore (435)       | 2.315.855         |
| 4             | Sigurime Shëndetësore(436)      | 320.888           |
| <b>TOTALI</b> |                                 | <b>10.831.335</b> |

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Dibër

#### **c-Testim për rregullshmërinë e aplikimit të pagave dhe shtesave mbi pagë.**

Për auditimin në lidhje me rregullshmërinë e pagave dhe shtesave u përzgjedhën pagesat që njësia publike bashkia Dibër ka kryer në muajin Tetor 2020 për 10 persona. Nga procesi auditimit në lidhje me rregullshmërinë për pagat e shtesat mbi pagë për 10 persona në muaji Tetor 2020 të përlllogaritura më sipër nuk u konstatuan diferenca. **Për vitin 2020**, pagat dhe shtesat janë kryer në përputhje me VKM nr.177 datë 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.165, datë 2.03.2016 “Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, si edhe në VKB nr.54 datë 27.03.2020 "Për miratimin e pagës së punonjësve të bashkisë Dibër, njësive dhe institucioneve në varësi për vitin 2020".

#### **d-Mbi evidentimin e konsumit të karburantit.**

Për vitin 2020, është vazhduar me të njëjtat normativa, si edhe viti 2019. Me VKB nr.140, datë 26.12.2019 është miratuar plani harxhimit të karburantit për vitin 2020 e konfirmuar me shkresë nr.16/1, datë 17.01.2020 Prefektura Dibër. Në çdo muaj është lëshuar urdhër magazinës nga Kryetari për sasinë e daljes së karburantit për secilin mjet, çdo muaj është përgatitur përmbledhësja e udhëtimeve të çdo mjet transporti firmosur nga specialisti dhe drejtuesi mjetit. Në përmbledhësen e udhëtimit janë shënuar destinacionin i lëvizjes dhe km rrugë të përshkuara, janë bërë llogaritjet për konsum të karburantit sipas normativave të konsumit të miratuara nga komisioni i miratuar nga titullari i Bashkisë.

#### **e-Transaksionet financiare të kryera me veprime nëpërmjet arkës.**

Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se: Nëpërmjet arkës janë kryer transaksione financiare, arkëtim të ardhura për detyrimet nga taksa e tokës bujqësore, taksat dhe tarifatat familjare, me mandat/arkëtim i plotësuar me gjithë ekstremitetet, sipas faturës për arkëtim të lëshuar nga sektori taksave e tarifave vendore, arkëtim për gjoba të policisë Bashkiake, apo IMTV. Nga arka nuk është kryer asnjë transaksion pagese.

Për vitin 2020 mandat/arkëtimet e prerë fillojnë me nr.1, datë 07.01.2020 me vlerë 195.920 lekë dhe mbyllet me nr.109, datë 29.12.2020 me vlerë 9.100 lekë. Në librin dhe ditarin e arkës konstatohet se, të ardhurat nga arkëtimet e kryera janë në vlerën 2,178,700 lekë, të cilat në fund të vitit janë derdhur totalisht në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe të vitit është me zero lekë. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara janë bërë derdhje në bankë në mënyrë periodike, ndërsa arka në fund të muajit rezulton me gjendje zero. Është mbajtur ditari arkës në formën klasike kontabël i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, si dhe UMFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 63; 64. Nga Drejtoria e Financës janë kryer Aktrakordini mujore dhe vjetore me degën e Thesarit Dibër për të ardhurat.

#### **f-Saktësia e plotësimit të Urdhër shpenzimeve.**

për periudhën objekt auditimi, në lidhje me urdhër shpenzimet u testuan dokumentet e transaksioneve të kryera nëpërmjet veprimeve me bankë konkretisht 3/mujori III, viti 2020, muaji korrik nga nr.522, datë 01.07.2020 vlera 84,000 lekë, deri nr.809, datë 24.09.2020 vlera 505,000 lekë.

Hartimi urdhër shpenzimeve është bërë mbi bazën e dokumentit mbështetës dhe justifikues, formati i tyre është sipas UMFE, ndërsa është aplikuar rregullisht sistemi i firmës së dyfishtë, duke nënshkruar nëpunësi autorizues dhe zbatues. Plotësimi është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktohen qartë objektet shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumenti justifikues. Urdhër shpenzimet janë konfirmuar nga Specialisti degës së Thesarit Dibër dhe janë likuiduar brenda limiteve të përcaktuara nga çelja e fondeve.

-Për rastet e likuidimit të punimeve në ndërtim, urdhër shpenzimi ka bashkangjitur këto dokumente: Urdhër Prokurimin, urdhri për ngritjen e KVO<sup>se</sup>, formulari njoftim fituesi, buletini APP për njoftim fituesi e njoftim kontrate, kontrata e lidhur midis palëve, situacioni punimeve të kryera, fatura e shitjes e subjektit përfitues, certifikata e përkohshme, ose përfundimtare e marrjes në dorëzim të punimeve, akt kolaudimi përfundimtar.

-Për rastet e blerjeve të materialeve, urdhër shpenzimi ka bashkangjitur këto dokumente: Urdhër Prokurimin, urdhër për ngritjen e KVO<sup>se</sup>, fotokopje e buletinit të APP për njoftim fituesi e njoftim për lidhje kontrate, fotokopje e kontratës së lidhur midis palëve, fatura e shitjes e subjektit përfitues, proces verbali marrjes në dorëzim dhe fletëhyrja e magazinës.

Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara, kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit. Ato transaksione e ngjarje që duhet të ishin regjistruar janë të regjistruara, ndërsa transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël dhe në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion. Shumat dhe të dhënat e tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

#### **g-Inventarizimi i aktiveve të Bashkisë.**

Për periudhën objekt auditimi, është kryer inventarizimi fizik i aktiveve të Bashkisë Dibër me urdhrin e titullarit nr.434, datë 03.12.2020 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimin të aktiveve të qëndrueshme dhe të inventarit të imët në Bashkinë Dibër dhe gjithë institucioneve përkatëse, për periudhën janar-dhjetor 2020”. Komisioni ka kryer inventarizimin fizik sipas përcaktimit në urdhër të Kryetarit të Bashkisë, përkatësisht në

shkolla, kopshte, çerdhe, konvikt, Bashki, Njësive Administrative, Bord i Kullimit, Shërbimi Pyjor, PMNZSH dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve, për llogaritë financiare përkatësisht sa më poshtë;

-llog.(202) “Studime e projekte”, vlera 56.390.670lekë,

-llog.(214) “Instalime teknike, makineri e pajisje”, vlera 97.128.537 lekë,

-llog.(215) “Mjete Transporti”, vlera 97.333.041 lekë,

-llog.(218) “Inventar ekonomik” vlera 144.657.392 lekë dhe

-llog.(32) “Objekte inventari”, në vlerën 8,690,670 lekë.

Në të gjitha rastet fletë inventari i gjendjes fizike është i nënshkruar nga personi përgjegjës material e komisioni inventarizimit. Në përfundim të procesit komisioni inventarizimit ka paraqitur raport mbi gjendjen e materialeve, ku për viti 2020 nga inventarizimi fizik nuk rezultuan diferenca, ndërsa janë konstatuar materiale në gjendje pune dhe të rregullta, për pasojë nuk kanë rezultuar materiale për tu nxjerrje jashtë përdorimit.

#### **Kriteri:**

VKM nr. 177, datë 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë Njësitë Vetëqeverisjes Vendore”. -VKB nr.54 datë 27.03.2020 "Për miratimin e pagës së punonjësve të bashkisë Dibër, njësive dhe institucioneve në varësi për vitin 2020". - UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

#### **Ndikimi/Efekti:**

Mos pasqyrim i saktë i vlerave inventar llog.(215) “Mjete transporti”, si edhe mos konfirmim i marrjes në dorëzim brenda 20 ditëve të muajit pasardhës, për çdo rast furnizimi i bëra nga donatorë të ndryshëm.

#### **Shkaku:**

Mos njohje e kërkesave ligjore

#### **Rëndësia: E mesme**

#### **Rekomandimi:**

Nga Bashkia Dibër të merren masa përkatësisht:

-Për rastet e furnizimeve që do të bëhen nga donatorë të ndryshëm brenda 20 ditëve, të muajit pasardhës të furnizimit të konfirmohet marrja në dorëzim e të gjitha furnizimeve, në përputhje me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap (III), pika 56.

-Për komisionet e inventarizimit fizik të AAGJM, në urdhra të vendosen emrat përkatës me përgjegjës të punonjësve që do të kryejnë inventarizimin me funksionin dhe detyrën që kryen, kërkesë e parashikuar me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 82.

## **IV. KONKLUZIONE TË PËRGJITHSHME DHE OPINIONI I AUDITIMIT**

### **IV/1-Konkluzione të përgjithshme gjatë auditimit.**

Në Bashkia Dibër nga Drejtoria e Financës janë përgatitur pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore viti 2020 dhe dorëzuar në degën e Thesarit Dibër brenda afatit ligjor. Nga analiza e referencave të llogarive të pasqyrave të pozicionit financiar kryesisht në rubrikat e aktiveve afat shkurtra, të aktiveve afatgjata dhe të pasive afat shkurtra u konstatua se:

**1-Në rubrikën, aktivet afat shkurtra. nënrubrika, llogari të arkëtueshme në llog.(468) “Debitorë të ndryshëm”. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;**

-Në këtë llogari nuk janë të pasqyruara të gjitha detyrimet debitorë të subjekteve private të lindura nga mos pagimi i nivelit të taksave e tarifave vendore, sepse nga evidentimi që ka bërë Sektori i taksave dhe tarifave vendore, rezulton që debitorët nga taksapagues privat e familjar janë në vlerën 40,132,137 lekë dhe jo sa paraqiten në pasqyrat financiare me vlerë 8,619,354 lekë me diferencë më pak vlera 31,52,783 lekë. Në këtë mënyrë pasqyrat financiare për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e detyrimeve debitorë, veprim në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, aneksi 1, pika 3.3.

**2-Në rubrikën, aktivet afat gjata. nënrubrika, aktive afat gjata materiale në llog.(210) “Toka, Troje, Terrene”. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;**

**a)** Vlera e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të konvikteve, godina e Bashkisë, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj., sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llog.(212) “Ndërtime e konstruksione”, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. II, pika 11, aneksi 1, pika 2, klasa 2.

**b)** Vlerat e trojeve të cilat kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Dibër, përkatësisht me VKM nr.1533, datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Peshkopi, qarku Dibër”; VKM nr.1179, datë 20.08.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në Komunën Melan, të qarkut të Dibrës”; VKM nr.1001 datë 10.12.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Arras, të qarkut të Dibrës”, veprim në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 30,

**c)** Nuk është kryer inventarizimi fizik dhe vlerësimi i trojeve, me komision të ngritur nga titullari i njësisë vendore, veprim në mospërputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. IV, pikat 74; 96, me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. II, pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2,

**3-Në rubrikën, aktivet afat gjata. nënrubrika, aktive afat gjata materiale, në llog.(211) “Pyje, kullota, plantacione”. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;**

**a)** Në llog.(211) “Pyje, kullota, plantacione” nuk është pasqyruar vlera e pyjeve e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Dibër me VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkisë të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkisë”, pika 8, shtojca nr.6 me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Dibër, me nr nga 1(një) deri 2327 (dymijë e treqind e njëzet e shtatë). Sipas këtij vendimi Bashkia Dibër ka në pronësi gjithsej **36,662** ha nga të cilët 25,351 ha pyje; 5,412 ha kullota, 534 ha sipërfaqe me bimësi pyjore, 3,417 ha sipërfaqe inproduktive, 1,889 ha sipërfaqe djerr dhe 57 ha sipërfaqe ujore. Veprim në mospërputhje me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 klasa 2.

**b)** Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi Pyjeve e Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit. Llog.(211) “Pyje, kullota, plantacione” nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve

në njësitë e sektorit publik”, Kap IV, pikat 74, 96. UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. II, pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2.

**4-Në rubrikën, aktivet afat gjata. nënrubrika, aktive afat gjata materiale, në llog.(212) “Ndërtim e konstruksione”. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;**

**a)** Nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë, që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksionit të objekteve, vlera mbikëqyrjes e kolaudit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë kosto të mëpasshme duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM<sup>së</sup>. Investimet në total shtesë deri në 31.12.2020, janë në vlerën 422,160,312 lekë për 22 objekte të evidentuar sipas aneksit nr.1, pika 3. Veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, germa ‘b’.

**b)** Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, veprim në mospërputhje me ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, pika 1; 2, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. IV, pika 74 dhe 96 dhe UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36, paragraf (4).

**5-Në rubrikën, aktivet afat gjata. nënrubrika, aktive afat gjata materiale në llog.(213) “Rrugë, rrjete vepra ujore”. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;**

**a)** Në përlllogaritjen e amortizimit vjetor të aktiveve afatgjata për periudhën raportuese ushtrimore 2020 në vlerën 168,386,227 lekë rezulton se norma mesatare vjetore është përlllogaritur me 5%, duke respektuar normën e amortizimit 5%, veprim në përputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36.

**b)** Nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme, duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM<sup>së</sup>. Investimeve shtesë deri në 31.12.2020 janë në vlerën 1,338,990,402 lekë, për 218 raste sipas aneksit nr.2, pika 3, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. II, pika 11, Aneksi 1, pika 2 Klasa 2, germa ‘b’.

**c)** Nuk është kryer inventarizimi e vlerësimi AAGJM<sup>ve</sup> me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, veprim në mospërputhje me ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, pikat 1 dhe 2; UMFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap.(IV), pika 74 dhe 96; UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36,

**6-Në rubrikën, aktivet afat gjata. nënrubrika, aktive afat gjata materiale në llog.(215) “Mjete transporti”. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;**

-Në llog.(215) “Mjete transporti” të pasqyrave të pozicionit financiar të vitit 2020 e cila paraqitet në vlerën 34,745,273 lekë është pasqyruar gabim edhe vlera prej 10,061,498 lekë për 8 (tetë) mjete transporti në gjendje të dëmtuara, pra është kryer kontabilizimi i gabuar në llog.(215) “Mjete Transporti”, ndërsa në fakt duhej të ishin të regjistruara dhe kontabilizuar në llog.(24) “Aktive afatgjata të dëmtuara” për 8 (tetë) mjete transporti të cilat nuk janë në gjendje pune, por të dëmtuara, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për

*procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(II), pika 11, aneksi 1, pika 2/1, germa (e) e pika 36.*

**7-Në rubrikën, aktivet afat gjata, nënrubrika, aktive afat gjata materiale në llog.(218) “Inventar ekonomik”. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;**

-Në pasqyrat e pozicionit financiar gjendja në datë 31.12.2019 paraqitet në vlerën 133,553,869 lekë, ndërsa nga përllogaritjet e pasqyrës së formati 7/b, gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afat gjata me vlerën neto, rezulton vlera neto prej 133,463,193 lekë, me diferencë më tepër për vlerën 90,676 lekë të pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar. Pra vlera neto e llogarisë 218 “Inventar ekonomik”, është pasqyruar gabim në vlerën 133,553,869 lekë, pasi duhet në vlerën 133,463,193 lekë. Veprimi është në mosrespektim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2, klasa 2.

**8-Në rubrikën, aktivet afat gjata, nënrubrika, investime në llog.(230) “Aktive afatgjata jo materiale”. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;**

-Sektori financës ka të analizuar e dokumentuar në mënyrë analitike e justifikuese vlerën e pasqyruar të pozicionit financiar vetëm për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 për 4 objekte me vlerë 6,907,636 lekë, ndërsa për periudhat paraardhëse nuk disponohet asnjë analizë dhe dokument justifikues, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(II), pikat 6; 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi; “Trajtimi kontabël dhe funksionimi grupi (20) “Aktive afatgjata jomateriale” dhe pika 18.

**9-Në rubrikën, aktivet afat gjata, nënrubrika, investime në llog.(231) “Për aktive afatgjata materiale”. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;**

-Sektori financës ka të analizuar e dokumentuar në mënyrë analitike e justifikuese vlerën e pasqyruar të pozicionit financiar vetëm për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 për 5 objekte me vlerë 330,426,810 lekë, ndërsa për periudhat paraardhëse nuk disponohet asnjë analizë dhe dokument justifikues, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(II), pikat 6; 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi; “Trajtimi kontabël dhe funksionimi grupi (20) “Aktive afatgjata jomateriale” dhe pika 18.

**10-Në rubrikën, pasivet afat shkurtra, nënrubrika, llogari të pagueshme në llog.(466) “Kreditorë për mjete në ruajtje”. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:**

**a)** Në pasqyrat e pozicionit financiar llog.(466) “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në vlerë 49,734,802 lekë e cila rakordon me gjendjen e pasqyruar, ndërsa nuk është e analizuar në mënyrë analitike për çdo objekt ndërtimi dhe operator ekonomik, si pasojë e mos pasqyrimin në Aktrakordimin dhe në evidencat analitike për të gjithë operatorët ekonomik që Bashkia ka detyrim në lidhje me vlerën e garancisë për punimet e përfunduara, apo ato në proces.

**b)** Për 33 objekte të përfunduara e të marra në dorëzim nga Bashkia që pasqyrohet në vlerën 13,013,172 lekë, sipas aneksit përkatës nuk është bërë zhbllokimi i vlerës, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në degën e Thesarit, megjithëse është përmbushur afati garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Veprime në mospërputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(III), pikat 30; 50.

**11-Bashkia Dibër** për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 rezulton se; Nuk ka hartuar pasqyrat e konsoliduar në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë, për të dhënë një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet dhe fluksin e mjeteve monetare. Në vartësi të njësisë publike Bashkia Dibër janë 4 (katër) Njësi publike vartësie konkretisht:

-Njësia Ekonomike, Qendra Balneare Peshkopi,

-Njësia Ekonomike, Qendra Kulturore Dibër,

-Njësia Ekonomike, Shumesportesh Dibër,

-Njësia Ekonomike, Klubi i Futbollit Dibër.

Për këtë periudhë, njësitë ekonomike në vartësi të Bashkisë Dibër pasqyrat e pozicionit financiar i kanë dorëzuar në degën e thesarit Dibër, ndërsa nuk kanë dorëzuar në Drejtorinë Ekonomike në Sektorin e Financës të Bashkisë Dibër, veprim në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”; neni 9, pika 4, germa (d), neni 12 pika 2, germa (b).

**12-Bashkia Dibër** për periudhën objekt auditimi viti 2020 rezulton se; Ka përfituar ndihma ushqimore e pajisje inventari nga (DPRMSH), për shkak të periudhës së pandemisë COVID<sup>19</sup>, si dhe për pasojat që u krijuan nga tërmeti i vitit 2019, ndërsa për të gjitha rastet e furnizimeve që janë bërë të cilat janë të dokumentuara me fletëhyrje të rregullt për çdo rast furnizimi, nuk është konfirmuar marrja në dorëzim e të gjitha furnizimeve të bëra gjatë vitit brenda afatit 20 ditë të muajit pasardhës, veprimi në mospërputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap.(III) “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, pika 56.

## **V. GJETJE DHE REKOMANDIME**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në rubrikën, aktive afat shkurtra, nën/rubrika, llogari të arkëtueshme, gjendja e llog.(468) “**Debitorë të ndryshëm**” në pasqyrat e pozicionit financiar në vitin 2020 paraqitet me vlerë 88,410,386 lekë e cila përfaqëson detyrime të shtuara nga subjekte të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore e detyrime të rezultuara në aktkontrolle të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2020. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se; për periudhën raportuese 2020 kjo vlerë përbëhet me analizë të hollësishme nga;

-Debitorë për taksat e tarifave vendore në vlerën 8,619,354 lekë.

-Debitorë të rekomanduar nga KLSH në vlerën 73,085,749 lekë.

-Debitorë të kopshteve e çerdheve në vlerën 2,956,340 lekë.

-Debitorë për letrat me vlerë në shumën 3,749,281 lekë.

Në këtë llogari janë nuk të pasqyruar të gjitha detyrimet debitorë të subjekteve private të lindura nga mos pagimi i nivelit të taksave e tarifave vendore, sepse nga evidentimi që bën Sektori Taksave e Tarifave Vendore, debitorët nga subjektet taksapagues privat dhe familjar janë në vlerën prej 40,132,137 lekë, ndërsa në pasqyrat financiare paraqiten me vlerën 8,619,354 lekë, me diferencë më pak prej 31,52,783 lekë. Në këtë mënyrë pasqyrat financiare për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e detyrimeve debitorë, veprim në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, aneksi 1, pika 3.3. (Më hollësisht trajtuar në pika A, faqe 18-34 të Raport Auditimit).



**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike, nëpërmjet Sektorit të Financës në bashkëpunim me Sektorin e taksave e tarifave vendore, të analizojnë dhe të marrin masa për sistemimin e vlerës së detyrimeve debitorë për taksat/tarifat e bizneseve/familjare, si dhe detyrime të tjera bazuar në listën e debitorëve gjendje në fund të vitit 2020.

#### **Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021.**

**2.Gjetje nga auditimi:** Në rubrika, aktivet afat gjata, nën/rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja e llog.(210) **“Toka, Troje, Terrene”** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet me vlerë 28,394,404 lekë e pa ndryshuar nga periudhat paraardhëse. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera ndër vite, kryesisht për shpronësim trualli shkolla e mesme, konvikti dhe shpronësim rruge tek gjimnazi i ri. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se, nuk është e pasqyruar:

**a)** Vlera e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të konvikteve, godina e Bashkisë, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj, sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llog.(212) **“Ndërtime e konstruksione”**, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 **“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”**, Kap.(II), pika 11, aneksi 1, pika 2 klasa 2.

**b)** Vlerat e trojeve të cilat kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Dibër, përkatësisht me VKM nr.1533, datë 19.11.2008 **“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Peshkopi, qarku Dibër”**; VKM nr.1179, datë 20.08.2008 **“Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në Komunën Melan, të qarkut të Dibrës”**; VKM nr.1001 datë 10.12.2010 **“Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Arras, të qarkut të Dibrës”**, veprim në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 **“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”**, pika 30,

**c)** Nuk është kryer inventarizimi fizik dhe vlerësimi i trojeve, me komision të ngritur nga titullari i njësisë vendore, veprim në mospërputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011 **“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”**, Kap. IV, pikat 74; 96, UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 **“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”**, Kap.(II), pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2. (Më hollësisht trajtuar në pika A, faqe 18-34 të Raport Auditimit).

**2.1.Rekomandimi:** Nga Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike nëpërmjet Sektorit të Financës të marr masa për të pasqyruara në llog.(210) **“Toka, Troje, Terrene”** edhe vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llog.(212) **“Ndërtime e konstruksione”**, vlera e të cilëve me VKM ka kaluar në pronësi të Bashkisë Dibër, njëkohësisht të kryhet inventarizimi i trojeve me komision inventarizimi.

#### **Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021.**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja e llog.(211) **“Pyje, kullota, plantacione”** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet me vlerë 2,468,000 lekë me ndryshime gjatë vitit për shtesën 1,200,000 lekë e cila përfaqëson vlerën e investimit të kryer me objekt **“ndërtim lere”**, vlerë e cila duhet të administrohet dhe kontabilizohet në llog.(213) **“Rrugë, rrjete, vepra ujore”**. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se nuk janë pasqyruar:

**a)** Vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Dibër, të transferuara me VKM nr.433, datë 08.06.2016 **“Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish/Komunat/Bashkive”**, pika 8, shtojca nr.6 e cila përmban listën e inventarit të pyjeve e

kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Dibër, nga nr.1(një) deri nr.2327 (dymijë e treqind e njëzet e shtatë). Sipas këtij vendimi Bashkia Dibër ka në pronësi gjithsej **36,662** ha (nga e cila 25,351 ha pyje; 5,412 ha kullotë; 534 ha sipërfaqe bimësi pyjore; 3,417 ha sipërfaqe inproduktive; 1,889 ha sipërfaqe djerr dhe 57 ha sipërfaqe ujore). Veprim në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap.(II), pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2.

**b)** Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i pyjeve e kullotave me komision të ngritur nga Titullari Institucionit. Llog.(211) “Pyje, kullota, plantacione” nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap IV, pikat 74, 96 dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. II, pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2. (Më hollësisht trajtuar në pika A, faqe 18-34 të Raport Auditimit).

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Sektorin e Pyjeve e Kullotave, të marrin masa për inventarizimin e pronave të cilat janë në pronësi të Bashkisë Dibër, si dhe të bëhet pasqyrimi i saktë në dokumentet kontabël vlerës së llog.(211) “Pyje, kullota, plantacione”. Njëkohësisht Drejtoria Ekonomike të bëjë sistemimin nga kjo llogari të vlerës së investimit të kryer me objekt “ndërtim lere” me vlerë 1,200,000 lekë e cila duhet të administrohet në llog.(213) “Rrugë, rrjete vepra ujore”.

**Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021.**

**4.Gjetje nga auditimi:** Në rubrikën, aktivet afat gjata. nën rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja në llog.(212) “Ndërtime e konstruksione” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet me vlerë 901,645,234 lekë e cila përfaqëson vlerën e investimeve të kryera gjatë vitit për ndërtime e rikonstruksione në 97,436 lekë dhe paksime në vlerën 47,455,012 lekë e amortizimit vjetor. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;

**a)** Nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë, që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksionit të objekteve, vlera mbikëqyrjes e kolaudit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë kosto të mëpasshme duhet të shtohen kostos fillestare të AAGJM<sup>së</sup>. Investimet në total shtesë deri në 31.12.2020 janë në vlerën 422,160,312 lekë për 22 objekte të evidentuar (Aneksi nr.5), bashkëlidhur. Veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, germa (b).

**b)** Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, veprim në mospërputhje me ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, pika 1; 2, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. IV, pika 74 dhe 96 dhe UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36, paragraf (4). (Më hollësisht trajtuar në pika A, faqe 18-34 të Raport Auditimit).

**4.1.Rekomandimi:** Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike, nëpërmjet Sektorit të Financës të analizojë dhe të marrë masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material në llog.(212) “Ndërtime e konstruksione”, duke shtuar në vlerën fillestare edhe vlerën e shpenzimit të investimit të ri për secilin objekt (rikonstruksion etj).

Njëkohësisht nëpunësi autorizues e zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik të Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM).

#### **Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021.**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në rubrikën, aktivet afat gjata, nënrubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja në llog.(215) *“Mjete transporti”* në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet me vlerë 34,745,237 lekë e cila përfaqëson vlerën e mjeteve ndër vite, shtesat gjatë periudhës e pakësimet nga amortizimi për periudhën raportuese ushtrimore. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se:

**a)** Në llog.(215) *“Mjete transporti”* të pasqyrave të pozicionit financiar është pasqyruar gabim vlera 10,061,498 lekë për 8 (tetë) mjete transporti gjendje të dëmtuara, kontabilizimi i gabuar në këtë llogari, ndërsa në fakt duhej të ishin regjistruar e kontabilizuar në llog.(24) *“Aktive afatgjata të dëmtuara”* për 8 (tetë) mjete transporti të cilat nuk janë në gjendje pune, por të dëmtuar, sipas (Aneksit nr.7), bashkangjitur, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, Kap.(II), pika 11, aneksi 1, pika 2/1, germa (e), pika 36. (Më hollësisht trajtuar në pika A, faqe 18-34 të Raport Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike, nëpërmjet Sektorit të Financës të analizojë dhe të marrë masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël për sistemimin e veprimeve për AAGJM dhe evidentimin e 8 mjete transporti të dëmtuar, me veprime kontabël, kreditim llog.(215) *“Mjete Transporti”* dhe debitim llog.(24) *“Aktive afat gjata të dëmtuara”* për vlerën përkatëse 10,061,498 lekë.

#### **Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021.**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, investime, gjendja në llog.(230) *“Për Aktive afatgjata jo materiale”* në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet me vlerë 18,131,232 lekë e cila përfaqëson vlerën e studime e projekte për investimet në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor, ndërsa do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre, kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë në llogaritë të Klasës (2) *“Aktive afat gjata materiale”*. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;

-Sektori financës ka të analizuar e dokumentuar në mënyrë analitike e justifikuese vlerën e pasqyruar të pozicionit financiar vetëm për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 për 4 objekte me vlerë 6,907,636 lekë, ndërsa për periudhat paraardhëse nuk disponohet asnjë analizë dhe dokument justifikues, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, Kap.(II), pikat 6; 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi *“Trajtimi kontabël dhe funksionimi”*, grupi (20) *“Aktive afatgjata jomateriale”*; pika 18. (Më hollësisht trajtuar në pika A, faqe 18-34 të Raport Auditimit).

**6.1.Rekomandimi:** Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike, nëpërmjet Sektorit të Financës të analizojë dhe të marrë masa për evidentimin dhe dokumentimin në mënyrë analitike për vlerën e studimeve e projekteve për investimet në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit pasqyruar në llog.(230) *“Për Aktive afatgjata jo materiale”* në vlerë 18,131,232 lekë.

#### **Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021.**

**7. Gjetje nga auditimi:** Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, investime, gjendja në llog.(231) *“Për aktive afatgjata materiale”* në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020, paraqitet me vlerë 545,659,534 lekë, e cila përfaqëson vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre, kur ato të kthehen aktive dhe kalojnë te llogaritë Klasa (2) *“Aktive afat gjata materiale”*. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se;

-Sektori financës ka të analizuar e dokumentuar në mënyrë analitike e justifikuese vlerën e pasqyruar të pozicionit financiar vetëm për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 për 5 objekte me vlerë 330,426,810 lekë, ndërsa për periudhat paraardhëse nuk disponohet asnjë analizë dhe dokument justifikues, veprim në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, Kap.(II), pikat 6; 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi “Trajtimi kontabël dhe funksionimi grupi (20) “Aktive afatgjata jomateriale” dhe pika 18. (Më hollësisht trajtuar në pika A, faqe 18-34 të Raport Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike, nëpërmjet Sektorit të Financës të analizojë dhe të marrë masa për evidentimin dhe dokumentimin në mënyrë analitike për vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe të pasqyruara në llog.(231) “Për aktive afatgjata materiale” në vlerë 545,659,534 lekë.

**Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021.**

**8. Gjetje nga auditimi:** Në rubrikën, pasivet afat shkurtra, nën/rubrika, llogari të pagueshme, gjendja në llog.(466) **“Kreditorë për mjete në ruajtje”** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet me vlerë 49,734,802 lekë e cila përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për 5% garanci në punimet e objekte të ndryshme të përfshirë ndër vite. Gjatë periudhës raportuese ushtrimore viti 2020, Sektori financës ka dokumentuar ngurtësime në vlerë 19,872,954 lekë për 12 OE, ndërsa ka likuiduar vlerën 4,792,686 lekë për 4 OE. Me degën e thesarit Dibër në datë 09.02.2021 janë mbajtur Aktrakordimin përkatësisht:

a) për 5% e ngurtësimeve progresive në vlerën 19,872,954 lekë deri më 31.12.2020.

b) për 5% e likuidimeve progresive në vlerën 4,792,686 lekë deri më 31.12.2020.

Ndërmjet vlerës së ngurtësimeve prej 19,872,954 lekë dhe vlerës së likuidimeve prej 4,792,686 lekë rezulton diferencë për 15,080,268 lekë e cila përfaqëson gjendje në datën 31.12.2020 e llog.(466) **“Kreditorë për mjete në ruajtje”** për detyrime të krijuara për gjatë vitit ushtrimor 2020. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se:

a) Në pasqyrat e pozicionit financiar llog.(466) **“Kreditorë për mjete në ruajtje”** paraqitet në vlerë 49,734,802 lekë e cila rakordon me gjendjen e pasqyruar, ndërsa nuk është e analizuar në mënyrë analitike për çdo objekt ndërtimi dhe operator ekonomik, si pasojë e mos pasqyrimit në Aktrakordimin dhe në evidencat analitike për të gjithë operatorët ekonomik që Bashkia ka detyrim në lidhje me vlerën e garancisë për punimet e përfunduara, apo ato në proces.

b) Për 33 objekte të përfunduara e të marra në dorëzim nga Bashkia që pasqyrohet në vlerën 13,013,172 lekë, sipas aneksit përkatës nuk është bërë zhbllokimi vlerës, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në degën e Thesarit, megjithëse është përmbushur afati garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga drejtoria e urbanistikës dhe financës, nuk janë marr masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar OE për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Veprime në mospërputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, Kap.(III), pikat 30; 50. (Më hollësisht trajtuar në pika A, faqe 18-34 të Raport Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Titullari Bashkisë Dibër, Drejtoria Ekonomike nëpërmjet Sektorit të Financës të analizojë dhe të marrin masa për sistemin e llog.(466) **“Kreditorë për mjete në ruajtje”** për evidentimin e dokumentimin në mënyrë analitike të diferencës prej 15,080,268 lekë e pa analizuar në mënyrë analitike. Të analizojnë origjinë krijimin e saj dhe shkaqet e mos likuidimit të vlerës 13,013,172 lekë e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve për ato objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim, duke analizuar më parë gjendjen nëse është

përmbyllur garancia e defekteve të punimeve, apo nëse janë bërë korrigjime të punimeve për ato kontrata që nuk është likuiduar garancia.

#### **Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021.**

**9. Gjetje nga auditimi:** Njësia publike Bashkia Dibër, për vitin ushtrimor 2020 nuk ka hartuar pasqyrat e konsoliduar në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë publike të varësisë, për ti dhënë një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për (*aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet e fluksin e mjeteve monetare*). Pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës viti 2020 katër njësitë ekonomike në vartësi të bashkisë Dibër i kanë dorëzuar në degën e thesarit Dibër, ndërsa nuk janë dorëzuar në Drejtorinë Ekonomike të Bashkisë Dibër. Në vartësi të njësisë publike Bashkia Dibër janë 4 (katër) Njësi publike vartësie konkretisht:

- Njësia Ekonomike, Qendra Balneare Peshkopi,
- Njësia Ekonomike, Qendra Kulturore Dibër,
- Njësia Ekonomike, Shumesportesh Dibër,
- Njësia Ekonomike, Klubi i Futbollit Dibër.

Veprim në mospërputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; neni 9, pika 4, germa “d”, neni 12 pika 2. germa “b”; UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pikat 98; 99; 100; 101, germa “b”; pika 118 (Më hollësisht trajtuar në pika A, faqe 18-34 të Raport Auditimit).

**9.1.Rekomandim:** Bashkia Dibër, Drejtoria Ekonomike, nëpërmjet Sektorit të Financës të analizojnë, të marrin masa për hartimin e pasqyrave të konsoliduar në nivel të vetëqeverisjes vendore së bashku me 4 (katër) Njësitë publike ekonomike në vartësi të Bashkisë Dibër.

#### **Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021.**

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**